



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE TË KOSOVËS
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU
MINISTARSTVO ZDRAVLJA



STRATEGJIA E SHËNDETIT MENDOR TË KOSOVËS 2008 - 2013

Dhjetor 2007, Prishtinë

Procesi i përpilimit të strategjisë është përkrahur nga
Organizata Botërore e Shëndetësisë, nëpërmjet fondeve të
Qeverisë Norvegjeze



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME VETËQEVERISËSE TË KOSOVËS
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU
MINISTARSTVO ZDRAVLJA



STRATEGJIA E SHËNDETIT MENDOR TË KOSOVËS 2008 - 2013

***DHJETOR 2007
PRISHTINË***

Fjala e Ministrit të Shëndetësisë

Strategjia e shërbimeve të shëndetit mendor të Kosovës është në përputhje me objektivat dhe prioritetet e Strategjisë së Shëndetësisë së Kosovës, Ky dokument është hartuar nga ekspert të ndryshëm shëndetësor dhe jo shëndetësor si dhe në konsultimin me shoqërinë civile.

Unë jam i bindur se ky dokument do ti shërbej Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institucioneve shëndetësor në përmirësimin e shërbimeve të shëndetit mendor, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve si dhe zbatimin e standardeve më të larta të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë.

Falënderoj grupin punues në hartimin e këtij dokumenti dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë për përkrahjen e vazhdueshme teknike gjatë procesit të hartimit të strategjisë së shërbimeve të shëndetit mendor të Kosovës.

Prof. Sadik Idrizi

Ministër i Shëndetësisë



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
LËNDA	5
VIZIONI	7
MISIONI	7
QËLLIMET.....	7
OBJEKTIVAT.....	7
AKTIVITETET	8
PRIORITETET 2008	33
PRIORITETET 2009	35
PRIORITETET 2010	36
PRIORITETET 2011	36
PRIORITETET 2012	37
MBIKQYRJA E ZBATIMIT	37
BUXHETI	37
SHTOJCA 1	38
SHTOJCA 2	50
SHTOJCA 3	53
SHTOJCA 4	56
SHTOJCA 5	59

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Reforma e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë në bazë të Planit Strategjik (2001) shënoi rezultate fillestare inkurajuese. U themelua shërbimi profesional i shëndetit mendor të Kosovës me shtatë struktura administrative të ndërlidhura në mënyrë funksionale, që me sukses filloi të ofron shërbime të shëndetit mendor të mbështetura në forcat përballuese të individit, familjes dhe bashkësisë së gjërë. Mirëpo, nevojat e mëdha në rrafshin e shëndetit mendor, kufizimet serioze buxhetore, vështirësitë në integrimin e shërbimeve spitalore dhe jashtëspitalore të shëndetit mendor, si dhe riorganizimi i Entit Special në Shtime si pjesë funksionale e Shërbimit të Shëndetit Mendor të Kosovës, imponuan nevojën për hartimin e planit të ri strategjik të shëndetit mendor të Kosovës 2008 – 2013.

Vizion i Strategjisë është sigurimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të shëndetit mendor për të gjithë banorët e Kosovës, të mbështetura në fuqitë individuale të klientit, aftësitë përballuese të familjes së tij, dhe resurset e bashkësisë ku jeton; në pajtim me veçoritë kulturore të popullatës dhe mundësitë reale ekonomike dhe financiare të vendit; me theks të veçantë në luftimin e stigmës ndaj të sëmurëve psikiatrik dhe çfarëdo diskriminimi.

Mision i Strategjisë është përparimi i mëtutjeshëm i sistemit të integruar dhe funksional të shërbimeve të shëndetit mendor, që disponon me resurse të mjaftueshme institucionale dhe profesionale për uljen e prevalencës së çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike, si dhe sigurimin e dinjitetit, integritetit dhe mëvetësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve, nëpërmjet: parandalimit efektiv; trajtimit gjithëpërfshirës multidisiplinar, të vazhdueshëm dhe me qasje të lehtë, të mbështetur në të dhëna shkencore; si dhe rehabilitimit adekuat psikosocial, të mbështetur në aftësitë përballuese të familjes dhe të mjedisit përkatës social.

Qëllimet e Strategjisë janë:

1. Shërbimet e integruara dhe funksionale të shëndetit mendor, që sigurojnë përmbushjen e standardeve të shërbimit të shëndetit mendor të Kosovës dhe OBSH-së¹.
2. Monitorimi, mbikqyrja dhe vlerësimi i rregullt i praktikave të punës së këtyre shërbimeve, nëpërmjet mbledhjes, analizës, dhe raportimit të rregulltë të informatave relevante.
3. Legjislacioni gjithëpërfshirës dhe funksional, që me prioritet rregullon: çështjen e hospitalizimeve dhe trajtimeve të detyruara, procesin e deinstitutionalizimit dhe sigurimin e të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

¹ Shtojca 1

Objektivat dhe aktivitetet e Strategjisë sipas qëllimeve dhe objektivave të parashtruara, janë:

1.1. Parandalimi efektiv i çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike.

- 1.1.1 Bashkëpunimi me shkollat fillore dhe të mesme, publike dhe private, në kuadër të strategjisë së shkollave për promovimin e shëndetit.
- 1.1.2 Bashkëpunimi i strukturave administrative të Shërbimit profesional të shëndetit mendor të Kosovës (SHPSHMK) me bashkësitë fetare, individët e regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor, dhe organizatat relevante joqeveritare.
- 1.1.3 Bashkëpunimi i strukturave administrative të SHPSHMK me shërbimet e mirëqenies sociale; shërbimet e punëve të brendshme dhe të sigurisë, sistemin gjyqësor dhe sistemin penal korrektues.

1.2 Trajtimi gjithëpërfshirës, i vazhdueshëm dhe me qasje të lehtë i mbështetur në të dhëna shkencore.

- 1.2.1 Organizimi i SHPSHMK, në shtatë struktura administrative, në bazë territoriale, të afta që t'u përgjigjen shumicës së nevojave të popullatës në lëminë e shëndetit mendor në territorin përkatës; si dhe themelimi i Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime si strukturë e veçantë administrative e SHPSHMK.
- 1.2.2 Organizimi i kujdesit për shëndetin mendor në tri nivele.
- 1.2.3 Sigurimi i vazhdimësisë së trajtimit në tri nivelet e kujdesit për shëndetin mendor.
- 1.2.4 Puna e standardizuar dhe integruar në SHPSHMK.
- 1.2.5 Organizimi, funksionimi unik dhe i integruar, si dhe zhvillimi i shërbimeve në sektorët specifik të shëndetit mendor, përfshirë zhvillimin e burimeve të domosdoshme, institucionale dhe njerëzore, sipas dinamikës së përcaktuar kohore, në pajtim me politikat shëndetësore dhe dokumentet strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë.

1.3 Rehabilitimi i suksesshëm psikosocial i shfrytëzuesve të shërbimeve të SHPSHMK.

- 1.3.1 Mbështetja e procesit të de-institucionalizimit të sëmurëve kronik psikiatrik nga: spitalet psikiatrike jashtë Kosovës², repartet psikiatrike në klinikën e psikiatrisë dhe spitalet rajonale, Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, dhe Shtëpitë për Integrim në Bashkësi.
- 1.3.2 Funkcionalizimi i të drejtave të sëmurëve psikiatrik në lëminë e mbrojtjes sociale.
- 1.3.3 Themelimi i kapaciteteve resocializuese, në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, për trajnime vokacionale dhe punësimin e të sëmurëve kronik psikiatrik, me qëllim të fuqizimit të rolit të tyre aktiv.

² Mendohet për pacientë kosovar që gjenden në trajtim në institucionet psikiatrike në Serbi dhe Maqedoni.

- 1.3.4 Bashkëpunimi institucional ndërmjet SHPSHMK, shërbimeve të mirëqenies sociale, dhe organizatave relevante joqeveritare.
 - 1.3.5 Programet e psikoedukimit në grupe shumëfamiljare sipas temave të caktuara.
- 1.4 Ngritja e kapaciteteve udhëheqëse në SHPSHMK, përfshirë udhëheqësit e reformës në lëmitë specifike të shëndetit mendor dhe menaxherët e strukturave të veçanta administrative.**
- 1.4.1 Planifikimi adekuat buxhetor, në bazë të parametrave relevant, me synim të çvendosjes së shpenzimeve buxhetore nga repartet psikiatrike spitalore kah shërbimet në komunitet.
 - 1.4.2 Themelimi i Sektorit të shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe sigurimi i përgjegjësisë administrative të drejtorëve të strukturave administrative të SHPSHMK ndaj udhëheqësit të këtij sektori.
 - 1.4.3 Sigurimi i trajnimeve relevante menaxheriale për stafin udhëheqës të SHPSHMK.
- 1.5 Koordinimi ndërsektorial i shërbimeve të shëndetit mendor me shërbimet e mirëqenies sociale, shërbimet e punëve të brendshme, shërbimet gjyqësore, sistemin penal, korrektues dhe shërbimet përkatëse në sektorin joqeveritar.**
- 1.5.1 Institucionalizimi i bashkëpunimit të SHPSHMK me shërbimet jashtë sektorit të shëndetësisë.
 - 1.5.2 Programet e trajnimeve të përbashkëta të profesionistëve të SHPSHMK me punëtorët e shërbimeve përkatëse të mirëqenies sociale, të punëve të brendshme, të shërbimeve gjyqësore, të sistemit penal dhe korrektues, si dhe me mësimdhënësit në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës.
- 1.6 Zhvillimi i bashkëpunimit profesional dhe shkencor me institucione vendore dhe ndërkombëtare akademike, përfshirë financimin nga buxheti i Kosovës.**
- 1.6.1 Bashkëpunimi institucional me asociacionet profesionale dhe shkencore, vendore dhe ndërkombëtare, në sektorin qeveritar dhe joqeveritar.
 - 1.6.2 Përcaktimi i projekteve prioritare hulumtuese në lëminë e shëndetit mendor.
 - 1.6.3 Mbështetja e anëtarësimit të asociacioneve profesionale vendore në asociacionet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare.
- 2.1 Zhvillimi i shërbimit për mbledhjen, analizën dhe raportimin e rregulltë të të dhënave statistikore përkitazi me funksionimin e SHPSHMK, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.**
- 2.1.1 Instalimi i sistemit elektronik të mbledhjes së të dhënave në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, pjesë e sistemit të unifikuar të informimit shëndetësor.
 - 2.1.2 Përgatitja e formularit të veçantë për mbledhjen e të dhënave në SHPSHMK.
 - 2.1.3 Përgatitja e sistemit të raportimit të rregulltë të të dhënave në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), çdo muaj.

2.1.4 Themelimi i sistemit të analizës së të dhënave në IKSHPK dhe raportimi i tyre i rregulltë, çdo tre muaj, në Zyren e Shëndetit Mendor, të Ministrisë së Shëndetësisë.

2.1.5 Përgatitja e raportit vjetor të IKSHPK mbi gjendjen e shëndetit mendor të popullatës së Kosovës dhe mbi shërbimet e ofruara nga SHPSHMK.

2.2 Vlerësimi i shërbimeve të SHPSHMK nga Ministria e Shëndetësisë, organizatat relevante joqeveritare dhe anëtarët e shoqërisë civile që kujdesen për mirëqenien e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

3.1 Përgatitja e Ligjit të Shëndetit Mendor të Kosovës.

3.1.1 Përgatitja e Memorandumit sqarues për arsyeshmërinë e nxjerrjes së Ligjit të shëndetit mendor.

3.2 Monitorimi i respektimit të të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendorë; të dinjitetit, të autonomisë dhe të mëvetësisë së tyre.

3.2.1 Themelimi dhe funksionalizimi i Bordit për të Drejtat e Njeriut të sëmurëve psikiatrik, në nivel të Zyres së Shëndetit Mendor të Ministrisë së Shëndetësisë.

3.2.2 Raportimi i rregulltë i institucioneve të SHPSHMK mbi shkeljet eventuale të të drejtave të njeriut të sëmurëve psikiatrik, në bazë të formularit të veçantë të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

3.2.3 Përpilimi i aktit përkatës nënligjor.

3.3 Bashkëpunimi institucional me Zyren për Qeverisje të Mirë në Qeverinë e Kosovës dhe institucionin e Ombudspersonit të Kosovës.

3.4 Bashkëpunimi i SHPSHMK me organizatat joqeveritare në lëminë e mbikqyrjes së të drejtave të të sëmurëve psikiatrik përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve.

3.4.1 Përgatitja e protokollit të bashkëpunimit me organizatat relevante joqeveritare.

3.5 Sigurimi i funksionalitetit të plotë të SHPSHMK.

Për çdo objektiv janë përcaktuar edhe indikatorët e përmbushjes.

Me këtë dokument janë përcaktuar poashtu edhe prioritetet sipas viteve për periudhën 2008 – 2013; mbikqyrja e zbatimit dhe projeksioni i detalizuar buxhetor për zbatimin e saj.

LËNDA

Plani strategjik i shëndetit mendor të Kosovës (2001) shënoi fillimin e ndryshimit të gjendjes në lëminë e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë. Me këtë Plan, krahas konceptit biologjik (medicinal) të organizimit u përvetësua edhe koncepti psikosocial i parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit të sëmundjeve dhe çrregullimeve psikiatrike. Shërbimet, ekskluzivisht psikiatrike dhe spitalore lëvizën kah shërbimet multidisiplinare që ofrohen në mjedisin ku jetojnë të sëmurët psikiatrik, ndërsa puna kryekëputë individuale filloi të shoqërohet me mbështetjen e familjeve të të sëmurëve psikiatrik. Duke e reflektuar realitetin psikosocial të Kosovës së pasluftës, plani si prioritet përcaktoi përkujdesin për të sëmurët kronik psikiatrik.

Plani mundësoi zhvillimin e resurseve të reja njerëzore dhe institucionale (Shtojca 3), ndërsa me Ligjin e shëndetësisë dhe aktet përcjellëse nënligjore u vu baza ligjore për funksionimin e shërbimit profesional të shëndetit mendor të Kosovës si shërbim i parë profesional, në nivel të vendit (në tekstin e mëtejme, SHPSHMK). Shërbimi ka organizim administrativ, në bazë territoriale me shtatë struktura të ndërlidhura funksionale, që ofrojnë shërbime të integruara, multidisiplinare, në tri nivele të kujdesit për shëndetin mendor duke mbështetur klientin dhe familjen e tij, nëpërmjet vënjes në funksion të resurseve të bashkësisë ku ai jeton.³

Puna e SHPSHMK mbështetet në parimet, si vijon: përmbushja e nevojave reale në territorin përfshirës; cilësia e shërbimeve; qasja adekuate; jo-diskriminimi; koordinimi dhe gjithëpërfshirja; mbështetja e familjes; besueshmëria; respektimi dhe përkrahja e dinjitetit, autonomisë, integritetit dhe mëvetësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve; si dhe koordinimi me shërbimet e mjekësisë familjare dhe shërbimet e përkujdesit social, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së marrëdhënies terapeutike.

Në periudhën e kaluar shtatëvjeqare u zbatuan shumë programe të trajnimeve sistematike dhe u përvetësuan metoda bashkëkohore të punës. Procesi i reformës u ndihmua me zhvillimin sistematik të resurseve njerëzore në lëminë e mjekësisë dhe infermierisë familjare si dhe fillimin e punës së Departamentit të Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës. Veçanërisht, u bënë përpjekje për ngritjen e standardeve profesionale dhe etike të punëtorëve të shëndetit mendor; respektimin e të drejtave të të sëmurëve psikiatrik si dhe deinstitutionalizimin e klientëve të Entit Special në Shtime.

Reforma e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë u mbështet në mënyrë sistematike në tërë periudhën e pasluftës nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), dhe shumë institucione dhe organizata të tjera akademike dhe donatore, qeveritare dhe joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare. Ndryshimet e arritura, shënuan avansim të qartë krahasuar me gjendjen e këtyre shërbimeve në shtetet fqinje. Në mes të tjerave, hulumtimet e bëra dëshmojnë uljen e dukshme të numrit të hospitalizimeve në repartet psikiatrike⁴ si dhe përmirësimin e kualitetit të punës me të sëmurët psikiatrik. (Shtojca 5)

Megjithatë, përkundër të arriturave evidente situata lenë, ende shumë për të dëshiruar. Finansimi i sektorit të shëndetësisë në përgjithsi dhe i shërbimeve të shëndetit mendor, në veçanti është tejet i ulët. Buxheti për sektorin e shëndetit mendor në vitin 2007 është dy herë më i vogël se buxheti për shëndet mendor në vitin 2004 dhe paraqet më pak se 3% të buxhetit të shëndetësisë (dy herë më pak se sa rekomandimet e OBSh); rrjedhimisht shumë kapacitete të ndërtuara të shëndetit mendor nuk mund të vehen në funksion për shkak të pamundësisë së punësimit të stafit të nevojshëm profesional.

³ Në tërë tekstin e këtij dokumenti, referimi në gjininë mashkullore e nënkupton edhe gjininë femërore

⁴ "Hospitalizimet në repartet Psikiatrike në Kosovë 1999-2006" (2007) A. Arënlju, F. Agani

Hulumtimi i bërë nga zyra e shëndetit mendor të OBSH në Prishtinë⁵ ka dokumentuar disa prej mangësive organizative të punës së shërbimeve të shëndetit mendor. Ndër to veçohen: kohëqëndrimi i gjatë në shtëpitë për integrim në bashkësi si dhe në qendrën integruese të shëndetit mendor në Shtime; koordinimi i dobët i aktiviteteve me shërbimet e mjekësisë familjare; koordinimi i dobët i aktiviteteve ndërmjet disa qendrave të shëndetit mendor dhe reparteve psikiatrike, përfshirë Klinikën e Psikiatrisë të QKUK; dhe bashkëpunimi jo adekuat me Fakultetin e Mjekësisë dhe Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Rrethanë specifike rënduese paraqet edhe numri, ende tejet i madh i të sëmurëve kronik psikiatrik nga Kosova, në spitalet psikiatrike në Serbi si dhe rehabilitimi dhe integrimi i vështirësuar psikosocial i banorëve jokosovar të Entit special në Shtime.

Pasojat komplekse psikologjike të traumave të luftës, zhvillimet e shpejta të tranzicionit kulturor dhe social, si dhe gjendja e rëndë ekonomike me shkallë të larta të papunësisë dhe të varfërisë⁶, paraqesin rrethana plotësuese rënduese për zhvillimin e mëtutjeshëm të SHPSHMK. Prevalencat e larta të Çrregullimit të Stresit Post-traumatik (22 %), të distresit emocional (43.6 %) dhe të depresionit (41.8 %) në popullatën 15 vjet dhe më të vjetër, gjashtë vite pas luftës⁷, e shtyen Ministrinë e Shëndetësisë, që ta miratojë Planin Kombëtar për Trauma Psikike⁸. Aktualisht, sëmundjet dhe çrregullimet mendore të kushtëzuara nga traumat psikike paraqesin problem për të cilin, SHPSHMK ende nuk ka përgjegje adekuate.

Indikatorë serioz i gjendjes është edhe indeksi në rritje i vetëvrasjeve në Kosovë (2.93/100.000), veçanërisht në mesin e adoleshentëve (një e treta e numrit të përgjithshëm).

Situata nuk është aspak më e mirë kur janë në pyetje sëmundjet e vartësisë si dhe problematika komplekse e psikiatrisë gjyqësore (forenzike); ndërsa problem në vehte paraqesin shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë, që krahasuar me strukturën demografike të popullatës së Kosovës janë ende shumë të pazhvilluara.

Faktor premtues për vazhdimin e suksesshëm të procesit të reformës paraqet motivacioni i lartë i punëtorëve të shëndetit mendor, organizimi çdo ditë e më i mirë në sektorin joqeveritar, përkrahja sistematike nga OBSH dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, si dhe gatishmëria e Ministrisë së Shëndetësisë për punë të mëtutjeshme në këtë drejtim.

Kufizues real të këtij procesi janë projeksionet e ulëta buxhetore të vendit në dy vitet vijuese, reformat e ngadalësuara në sektorin e shëndetësisë, moszbatimi i ligjshmërisë si dhe vështirësitë e integritit të shërbimeve për të sëmurët mendor në territoret e banuara nga popullata serbe.

Duke marrë parasysh faktet e lartëpërmendura si dhe të dhënat epidemiologjike nga OBSH se problemet e shëndetit mendor paraqesin 12,3% të sëmundjeve të përgjithshme dhe 30, 8% të shkaqeve të paaftësive për punë, nevoja për përparimin e mëtutjeshëm të shërbimeve të shëndetit mendor të Kosovës, nëpërmjet veprimeve të mirëfillta strategjike, paraqitet si imediate dhe urgjente.

⁵ Instrumenti vlerësues i shërbimeve të shëndetit mendor. OBSH. Shtator 2006.

⁶ 'Labor Market and Unemployment in Kosova', draft research report, RIINVEST, January 2003. p.13.

⁷ "Long-term sequels of war, social functioning and mental health in Kosovo". Thomas Venzel, Bajram Maxhuni, Ferid Agani, Feride Rushiti and Ismet Abdullahu, Kosovo, August 2006.

⁸ Prevalence of suicidal preoccupations among Kosovar's 15 year and older. Conference of the Albanian Psychiatry League. Tirana, Albania. September 29-30 2006.

VIZIONI

Sigurimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të shëndetit mendor për të gjithë banorët e Kosovës, të mbështetura në fuqitë individuale të klientit, aftësitë përballuese të familjes së tij, dhe resurset e bashkësisë ku jeton; në pajtim me veçoritë kulturore të popullatës dhe mundësitë reale ekonomike dhe financiare të vendit; me theks të veçantë në luftimin e stigmës ndaj të sëmurëve psikiatrik dhe çfarëdo diskriminimi.

MISIONI

Përparimi i mëtutjeshëm i sistemit të integruar dhe funksional të shërbimeve të shëndetit mendor, që disponon me resurse të mjaftueshme institucionale dhe profesionale për uljen e prevalencës së çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike, si dhe sigurimin e dinjitetit, integritetit dhe mëvetësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve, nëpërmjet: parandalimit efektiv; trajtimit gjithëpërfshirës multidisiplinar, të vazhdueshëm dhe me qasje të lehtë, të mbështetur në të dhëna shkencore; si dhe rehabilitimit adekuat psikosocial, të mbështetur në aftësitë përballuese të familjes dhe të mjedisit përkatës social.

QËLLIMET

Qëllimet e strategjisë janë:

4. Shërbimet e integruara dhe funksionale të shëndetit mendor, që sigurojnë përmbushjen e standardeve të shërbimit të shëndetit mendor të Kosovës dhe OBSH⁹.
5. Monitorimi, mbikqyrja dhe vlerësimi i rregullt i praktikave të punës së këtyre shërbimeve, nëpërmjet mbledhjes, analizës, dhe raportimit të rregulltë, të informatave relevante.
6. Legjislacioni gjithëpërfshirës dhe funksional, që me prioritet rregullon: çështjen e hospitalizimeve dhe trajtimeve të detyruara, procesin e deinstitutionalizimit, si dhe sigurimin e të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

OBJEKTIVAT

Objektivat e strategjisë sipas qëllimeve të parashtruara, janë:

1. Parandalimi, trajtimi dhe rehabilitimi bashkëkohor i sëmundjeve dhe çrregullimeve psikiatrike.

- 1.2 Parandalimi efektiv i çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike.
- 1.2 Trajtimi gjithëpërfshirës, i vazhdueshëm, me qasje të lehtë, i mbështetur në të dhëna shkencore; me theks të veçantë në integrimin e plotë, funksional, të strukturave spitalore dhe jashtspitalore të shërbimeve të shëndetit mendor.
- 1.3 Rehabilitimi i suksesshëm psikosocial që mbështetet në aftësitë përballuese të familjes dhe resurset e bashkësisë rrethuese dhe më të gjërë.

⁹ Shtojca 1

- 1.4 Ngritja e kapaciteteve udhëheqëse, përfshirë lëmitë specifike të shëndetit mendor dhe menaxherët e strukturave të veçanta administrative.
- 1.5 Koordinimi ndërsektorial me shërbimet e mirëqenies sociale, punëve të brendshme, sistemit gjyqësor, penal dhe korrektues, si dhe shërbimet përkatëse në sektorin joqeveritar.
- 1.6 Bashkëpunimi profesional dhe shkencor me institucione akademike, vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë financimin e programeve nga buxheti i Kosovës.

2. Monitorimi, mbikqyrja dhe vlerësimi i rregullt.

- 2.1 Sistemi i mbledhjes, analizës dhe raportimit të rregullt të të dhënave statistikore përkitazi me funksionimin e SHPSHMK, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.
- 2.2 Mbikqyrja dhe vlerësimi i shërbimeve të SHPSHMK nga Ministria e Shëndetësisë; nga organizatat relevante joqeveritare dhe anëtarët e shoqërisë civile, që kujdesen për mirëqenien e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

3. Legjislacioni

- 3.1 Përgatitja e Ligjit të Shëndetit Mendor të Kosovës.
- 3.2 Monitorimi i respektimit të drejtave, dinjitetit, autonomisë dhe mëvetësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendorë.
- 3.3 Bashkëpunimi institucional me Zyrën e Kryeministrit dhe institucionin e Ombudspersonit.
- 3.4 Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare në lëminë e mbikqyrjes së të drejtave të sëmurëve psikiatrik përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve.
- 3.5 Shfrytëzimi i pasurive të klientëve të Entit Special në Shtime dhe Shtëpive për Integrim në bashkësi në funksion të rehabilitimit të tyre sa më të suksesshëm psikosocial.
- 3.6 Shfrytëzimi i mundësive për punësimin e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

AKTIVITETET

Aktivitetet e strategjisë sipas objektivave të parashtruara, janë:

1.1. Parandalimi efektiv i çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike.

1.1.1 Bashkëpunimi me shkollat fillore dhe të mesme, publike dhe private, në kuadër të strategjisë së shkollave për promovimin e shëndetit.

- 1.1.1.1 Përpilimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sportit.
- 1.1.1.2 Aktivitete në institucionet shkollore, në bazë të memorandumit nga pika paraprake.
- 1.1.1.3 Publikime të rregullta, përkitazi me tema relevante për institucionet shkollore.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.1.1

- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sportit.
- Së paku dy aktivitete të realizuara në vit, në çdo shkollë fillore dhe të mesme, në bazë të programit paraprakisht të dakorduar me MASHT.
- Botimi i publikimeve didaktike, çdo gjasht muaj, përkitazi me parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve psikiatrike nën autorizimin e Këshillit të veçantë redaktues (udhëheqësi i sektorit të shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë; Përgjegjësi në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, dhe Kryetarët e Asociacioneve të Psikiatërve, Psikologëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor, të Kosovës.

1.1.2 Bashkëpunimi i strukturave administrative të SHPSHMK me bashkësitë fetare, individët e regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor, dhe organizatat relevante joqeveritare.

- 1.1.2.1 Përgatitja e debatit me përfaqësues të bashkësive fetare.
- 1.1.2.2 Përgatitja e debatit me përfaqësues të individëve të regjistruar, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.
- 1.1.2.3 Përgatitjet për tryeza të rregullta koordinuese me organizatat joqeveritare dhe përfaqësues të sektorit civil, që zhvillojnë aktivitetete në lëminë e shëndetit mendor, në territorin përkatës.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.1.2

- Organizimi i dy tryezave të debatit, brenda një viti, me përfaqësues të bashkësive relevante fetare.
- Organizimi i dy tryezave të debatit, brenda një viti, me përfaqësues të individëve të regjistruar, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.
- Organizimi i tryezave të rregullta mujore të koordinimit të organizatave joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, që zhvillojnë aktivitetete në lëminë e shëndetit mendor, në territorin përkatës.
- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe organizatave relevante joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare.

1.1.3 Bashkëpunimi i strukturave administrative të SHPSHMK me shërbimet e mirëqenies sociale; shërbimet e punëve të brendshme dhe të sigurisë, sistemin gjyqësor dhe sistemin penal korrektues.

- 1.1.3.1 Përpilimi i protokollit të bashkëpunimit me qendrat komunale për punë sociale.

- 1.1.3.2 Përpilimi i protokolit të bashkëpunimit me institucionet komunale të shërbimit të punëve të brendshme.
- 1.1.3.3 Përpilimi i Memorandumit të bashkëpunimit me institucionet e sigurisë.
- 1.1.3.4 Përpilimi i Protokolit të bashkëpunimit me institucionet përkatëse të gjyqësorit dhe të sistemit penal korrektues.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.1.3

- Miratimi i protokolit të bashkëpunimit me qendrat komunale për punë sociale.
- Miratimi i protokolit të bashkëpunimit me njësitë përkatëse të shërbimeve të punëve të brendshme.
- Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me njësitë përkatëse të institucioneve të sigurisë.
- Miratimi i protokolit të bashkëpunimit me institucionet përkatëse të gjyqësorit dhe të sistemit penal korrektues.

1.2 Trajtimi gjithëpërfshirës, i vazhdueshëm dhe me qasje të lehtë, i mbështetur në të dhëna shkencore.

1.2.1 Organizimi i SHPSHMK, në shtatë struktura administrative, në bazë territoriale, të afta që t'u përgjigjen shumicës së nevojave të popullatës në lëminë e shëndetit mendor, në territorin përkatës; si dhe themelimi i Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime si strukturë e veçantë administrative e SHPSHMK.

- 1.2.1.1 SHPSHMK Prishtinë, përfshinë komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Glogovc, Novo Bërd. Përafërsisht: 460.818 banorë.
- 1.2.1.2 SHPSHMK Mitrovicë, përfshinë komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok. Përafërsisht: 250.967 banorë.
- 1.2.1.3 SHPSHMK Gjilan, përfshinë komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti. Përafërsisht: 197.585 banorë.
- 1.2.1.4 SHPSHMK Ferizaj, përfshinë komunat: Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpc. Përafërsisht: 175.651 banorë.
- 1.2.1.5 SHPSHMK Pejë, përfshinë komunat: Pejë, Istog, Klinë, Deçan. Përafërsisht: 276.440 banorë.
- 1.2.1.6 SHPSHMK Gjakovë, përfshinë komunat: Gjakovë dhe Malishevë dhe Rahovec. Përafërsisht: 236.727 banorë.
- 1.2.1.7 SHPSHMK Prizren, përfshinë komunat: Prizren, Suharekë, Dragash. Përafërsisht 255.852 banorë.
- 1.2.1.8 Qendra për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime si strukturë e veçantë administrative e SHPSHMK.

Indikatori i përmbushjes së objektivave 1.2.1

- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (shëndetësi) 1/2005.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për themelimin e Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.

1.2.2 Organizimi i kujdesit për shëndetin mendor në tri nivele:

1.2.2.1 Niveli parësor i kujdesit për shëndetin mendor organizohet në kuadër të shërbimeve të mjekësisë familjare dhe shërbimeve të mirëqenies sociale, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile në përgjithsi, përfshirë individët e regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.

1.2.2.1.1 Shërbimet e mjekësisë familjare:

- Përcjellin zhvillimin psikologjik dhe fizik të fëmijëve; identifikojnë rastet e moskujdesit prindëror ose abuzimit të fëmijëve dhe ndërmarrin masa adekuate, në pajtim me ligjin;
- Identifikojnë të sëmurët nga çrregullimet serioze psikike, dhe bëjnë udhëzimin e tyre në qendrat e shëndetit mendor;
- Njoftohen me regjimet e trajtimit kohëgjatë medikamentoz, veçanërisht terapisë depo-neuroleptike dhe përcjellin marrjen e rregulltë të terapisë në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet përkatëse të shëndetit mendor;
- Identifikojnë dhe këshillojnë në rastet e keqpërdorimit të substancave psikoaktive (duhani, alkoholi, drogat);
- Identifikojnë traumat psikike dhe ndërmarrin trajtimin fillestar;
- Ndërmarrin veprimtari psikoedukative në grupe shumëfamiljare, përkthazi me sëmundjet dhe çrregullimet kryesore psikiatrike, në bashkëpunim me SHPSHMK.

1.2.2.1.2 Shërbimet e mirëqenies sociale identifikojnë klientët të cilët kanë nevojë për shërbime profesionale të shëndetit mendor dhe bëjnë referimin e tyre, në bazë të protokoleve zyrtare të referimit.

1.2.2.1.3 Organizatat joqeveritare ofrojnë shërbime të shëndetit mendor për kategori të caktuara të qytetarëve dhe ndërlidhin aktivitetin e tyre me strukturën përkatëse administrative të SHPSHMK.

1.2.2.1.4 Bashkëpunimi i SHPSHMK me individë të regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.

1.2.2.2 Shërbimet në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit për shëndetin mendor ofrohen nga SHPSHMK¹⁰.

1.2.2.2.1 Njësitë funksionale të çdo strukture administrative të SHPSHMK, përveç Prishtinës, janë:

- Hapësira punuese, në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, për shërbimet jashtspitalore të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve (deri në ndërtimin e qendrës përkatëse).
- Reparti psikiatrik me:
 - Njëzet shtretër për të rritur;
 - Gjashtë shtretër për kujdes intensiv psikiatrik;
 - Dy shtretër për sëmundje të vartësisë.
- Dy qendra të shëndetit mendor.
- Dy shtëpi për integrim në bashkësi dhe
- Një qendër e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve.

1.2.2.2.2 Njësitë funksionale të SHPSHM të Prishtinës, janë:

- Klinika e Psikiatrisë me:
 - Shtatëdhjetë e dy shtretër për të rritur;
 - Tetëmbëdhjetë shtretër për kujdes intensiv psikiatrik;
 - Katër shtretër për sëmundje të vartësisë; deri në ndërtimin e Institutit të sëmundjeve të vartësisë;
 - Dymbëdhjetë shtretër për psikiatri gjyqësore (forenzike); deri në ndërtimin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike.
- Katër qendra të shëndetit mendor.
- Tri shtëpi për integrim në bashkësi.
- Qendra për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, me repart psikiatrik prej dymbëdhjetë shtretërve.
- Instituti i Psikiatrisë Forenzike me tridhjetëgjashtë shtretër.
- Instituti për sëmundje të vartësisë me njëzet shtretër.

1.2.2.2.3 Repartet psikiatrike të strukturave administrative të SHPSHMK të Gjakovës dhe të Gjilanit duhet të kenë njësinë për ofrimin e shërbimeve spitalore të psikiatrisë forenzike (gjyqësore) me gjashtë shtretër.

1.2.2.2.4 Shërbimet në nivelin dytësor të kujdesit për shëndetin mendor, ofrohen në bazë të programeve

¹⁰ Udhëzimi administrativ (në shëndetësi) 1/2005.

unike të punës, të bazuara në të dhëna shkencore; të miratuara nga asociacionet relevante profesionale të vendit (Shtojcat, 2).

1.2.2.3 Shërbimet në nivelin tretësor të kujdesit për shëndetin mendor ofrohen nga strukturat administrative të SHPSHMK, si vijon: Klinika e Psikiatrisë e QKUK, Qendra Universitare e Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshentëve, Instituti i Psikiatrisë Forenzike, Instituti i Sëmundjeve të Vartësisë, Qendra për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime dhe Qendra Kombëtare e Ekspertizës për Trauma Psikike.

1.2.2.3.1 Shërbimet në nivelin tretësor të kujdesit për shëndetin mendor, ofrohen në bazë të programeve unike të punës, të bazuara në të dhëna shkencore, dhe të miratuara nga asociacionet relevante profesionale të vendit (Shtojcat, 2).

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.2.2

- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (shëndetësi) 1/2005, që siguron hapësirën punuese për njësinë e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë, në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, deri në ndërtimin e qendrave përkatëse.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ mbi regjistrimin e individëve, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.
- Ndërtimi i gjashtë qendrave të reja të shëndetit mendor (Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj), sipas dinamikës së përcaktuar kohore – çdo vit nga një qendër.
- Aktivizimi i shtëpive për integrim në bashkësi, në Pejë dhe Skenderaj prej 1 Janarit 2008.
- Ndërtimi i gjashtë shtëpive të reja për integrim në bashkësi (Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj), sipas dinamikës së përcaktuar kohore – çdo vit nga një shtëpi.
- Ndërtimi i gjashtë qendrave të reja të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve (Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj), sipas dinamikës së përcaktuar kohore – çdo vit nga një qendër.
- Themelimi i repartit psikiatrik në Mitrovicë, më njësitë përbërëse.
- Themelimi i Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, deri më 1 Janar 2008.
- Themelimi i Njësisë rehabilituese - vokacionale të të sëmurëve kronik psikiatrik, në kuadër të Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, deri më 1 Janar 2009.

- Fillimi i punës së njësisë të psikiatrisë forenzike (gjqësore), të reparteve psikiatrike në Gjakovë dhe në Gjilan, me 1 Janar 2009.
- Fillimi i punës së qendrës së shëndetit mendor në Podujevë (1 Janar 2008).
- Fillimi i punës së shtëpisë për integrim në Drenas (1 Janar 2008).
- Ndërtimi i një qendre të shëndetit mendor në Prishtinë (deri më 1 Janar 2011).
- Ndërtimi i dy shtëpive të reja për integrim (deri më 1 Janar 2013).
- Ndërtimi i aneksit spitalor të Qendrës së shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, me repart psikiatrik prej dymbëdhjetë (12) shtretërve (deri më 1 Janar 2010).
- Ndërtimi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike (deri më 1 Janar 2009).
- Ndërtimi i Institutit për sëmundje të vartësisë (deri më 1 Janar 2010).

1.2.3 Sigurimi i vazhdimësisë së trajtimit në tri nivelet e kujdesit për shëndetin mendor.

- 1.2.3.1 Bashkëpunimi institucional ndërmjet SHPSHMK dhe Drejtorive komunale të shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale.
- 1.2.3.2 Sistemi zyrtar i referimit nga niveli parësor në nivelin dytësor të kujdesit për shëndetin mendor.
- 1.2.3.3 Sigurimi i zbatimit të shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë në hapësirat e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, nën përgjegjësinë administrative të SHPSHMK.
- 1.2.3.4 Mbikqyrja terapeutike e të sëmurëve kronik psikiatrik nga ana e shërbimeve të mjekësisë familjare.
 - 1.2.3.4.1 Trajnimi përkatës dhe referimi për terapi depo neuroleptike në Qendrat përkatëse të shëndetit mendor.
- 1.2.3.5 Sigurimi i mbikqyrjes së të sëmurëve psikiatrik në repartet psikiatrike, spitalore dhe klinike, nga ana e ekipeve të qendrave të shëndetit mendor.
 - 1.2.3.5.1 Integrimi administrativ i reparteve psikiatrike në kuadër të strukturës përkatëse administrative të SHPSHMK deri në fund të vitit 2013, fillimisht në kuadër të pilot projektit në SHPSHM të Gjakovës, që do të fillojë me 1 Janar 2008.
- 1.2.3.6 Ofrimi i shërbimeve specialistike psikiatrike për pacientë jasht-spitalor në mjediset e qendrave të shëndetit mendor.
- 1.2.3.7 Zbatimi i punës sistematike, të ekipeve multidisciplinare të qendrave të shëndetit mendor në teren, nëpërmjet vizitave shtëpiake të pacientëve të identifikuar, në bazë të kritereve të përcaktuara.

- 1.2.3.8 Përpilimi i protokoleve të referimit në institucionet e nivelit tretësor të kujdesit për shëndetin mendor, përfshirë kriteriumet e definuara për këtë qëllim, si dhe mekanizmat e bashkëpunimit me nivelin parësor dhe nivelin dytësor të kujdesit për shëndetin mendor, si dhe me institucionet e sistemit gjyqësor dhe sistemit penal korrektues.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.2.3

- Nënshkrimi i Memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse territoriale të SHPSHMK dhe Drejtorive komunale të shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale.
- Miratimi i protokoleve të referimit nga shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet e mirëqenies sociale, organizatat relevante joqeveritare dhe individët e regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor, në strukturat përkatëse administrative të SHPSHMK.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për sigurimin e zbatimit të shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë si pjesë funksionale e shërbimeve të mjekësisë familjare, nën përgjegjësinë administrative të SHPSHMK.
- Zbatimi i terapisë depo-neuroleptike në qendrat e shëndetit mendor pas referimit nga shërbimet e mjekësisë familjare.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (shëndetësi) 1/2005 me të cilin do të sigurohet integrimi administrativ i repartit psikiatrik të spitalit të Gjakovës në kuadër të strukturës administrative të SHPSHM të Gjakovës, dhe ndryshimi i statutit të spitalit të Gjakovës, në këtë drejtim.
- Miratimi i protokoleve të referimit në institucionet e nivelit tretësor të kujdesit për shëndetin mendor.

1.2.4 Puna e standardizuar dhe integruar në SHPSHMK.

- 1.2.4.1 Njësi përbërëse, administrative dhe funksionale e çdo strukture administrative të SHPSHMK, janë:
- 1.2.4.1.1 Reparti psikiatrik (spitalor ose klinik) me njësinë e kujdesit intenziv psikiatrik, njësinë për sëmundje të vartësisë, dhe njësinë për psikiatrinë forenzike;
 - 1.2.4.1.2 Qendrat e shëndetit mendor;
 - 1.2.4.1.3 Shtëpitë për integrim në bashkësi dhe
 - 1.2.4.1.4 Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshent.
- 1.2.4.2 Struktura administrative e SHPSHMK e Prishtinës përbëhet nga numër më i madhë i njësive funksionale, përfshirë edhe institucionet e nivelit tretësor të kujdesit për shëndetin mendor.
- 1.2.4.3 Qendra për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime paraqet strukturë të veçantë administrative të SHPSHMK dhe përbëhet nga dy pjesë themelore: reparti psikiatrik me tridhjetë shtretër dhe njësia vokacionale – rehabilituese me njëzet shtretër.

- 1.2.4.4 Në komuna me më shumë se pesëdhjetëmijë (50.000) banorë, mund të themelohen njësitë përbërëse nga pika 1.2.4.1.
- 1.2.4.5 Puna në repartet psikiatrike, spitalore dhe klinike, në qendrat e shëndetit mendor, në shtëpitë për integrim në bashkësi, në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, dhe në shërbimet e shëndetit mendor të fëmijëve dhe të adoleshentëve, zbatohet në bazë të programeve unike, të bazuara në të dhëna shkencore; të propozuara nga asociacionet relevante profesionale të vendit, dhe të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- 1.2.4.6 Gjatë ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor, krahas individualitetit të klientit theksohet edhe roli mbështetës i familjes dhe i rrjetave mbështetëse sociale.
- 1.2.4.7 Integrimi i njësive funksionale të strukturës administrative të SHPSHMK, sigurohet nëpërmjet punës në Bordet konsultative të shëndetit mendor, që organizohen në çdonjërin nga strukturat administrative të SHPSHMK.
- 1.2.4.8 Në strukturat përbërëse administrative të SHPSHMK zbatohet punë e standardizuar, e integruar dhe e koordinuar me shërbimet e mjekësisë familjare dhe me shërbimet e mirëqenies sociale.
- 1.2.4.9 Në strukturat përbërëse administrative të SHPSHMK zbatohen protokolet unike të trajtimit dhe të rehabilitimit psikosocial, sipas entiteteve të ndryshme klinike.
- 1.2.4.9.1 Përpilimi i protokoleve unike të trajtimit dhe të rehabilitimit psikosocial, të propozuara nga asociacionet relevante profesionale vendore.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.2.4

- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (shëndetësi) 1/2005, me qëllim të zyrtarizimit të programeve unike të trajtimit, të bazuara në të dhëna shkencore, të propozuara nga asociacionet relevante profesionale të vendit dhe të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për sigurimin e bashkëpunimit funksional të SHPSHMK me shërbimet e mjekësisë familjare dhe me shërbimet e mirëqenies sociale.
- Miratimi i protokoleve të trajtimit dhe të rehabilitimit psikosocial, sipas entiteteve të veçanta klinike, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

1.2.5 Organizimi, funksionimi unik dhe i integruar, si dhe zhvillimi i shërbimeve në sektorët specifik të shëndetit mendor, përfshirë zhvillimin e resurseve të domosdoshme, institucionale dhe njerëzore, sipas dinamikës së përcaktuar kohore, në pajtim me politikat shëndetësore dhe dokumentet strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë.

1.2.5.1 Rritja e numrit të psikiatërve për të rritur, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.

1.2.5.2 Organizimi, funksionimi dhe zhvillimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë.

1.2.5.2.1 Përpilimi i programit unik për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë¹¹, me të cilin përcaktohet se:

- Niveli parësor i kujdesit për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve organizohet në kuadër të shërbimeve të mjekësisë familjare, në bazë të aktit të veçantë nënligjor.
- Niveli dytësor i kujdesit për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve organizohet në kuadër të rrjetit të shtatë qendrave të shëndetit mendor të fëmijëve dhe të adoleshentëve, pjesë të SHPSHMK.
- Niveli tretësor i kujdesit për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve organizohet në kuadër të njësisë së veçantë spitalore në QKUK, pjesë përbërëse e SHPSHMK.
- Shërbimet në njësitë e lartëpërmendura të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë do të ofrohen nga ekipet multidisiplinare të përbëra nga psikiatër dhe psikolog të fëmijëve dhe adoleshentëve, infermierë dhe punëtorë social.
- Aftësimi profesional i kuadrit të nevojshëm për funksionimin e shërbimit, sipas profileve relevante disiplinare dhe dinamikës së përcaktuar kohore.
- Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë me shërbimet e tjera të SHPSHMK sigurohet nëpërmjet pjesëmarrjes në Bordet konsultative të shëndetit mendor.
- Rritja e numrit të psikiatërve të fëmijëve dhe adoleshentëve, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.

¹¹ Shtojca 2

1.2.5.3 Organizimi, funksionimi dhe zhvillimi i shërbimeve të psikiatrisë gjyqësore.

1.2.5.3.1 Përpilimi i programit unik për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shërbimeve të psikiatrisë gjyqësore (forenzike), me të cilin përcaktohet:

- Themelimi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike (IPF), si pjesë përbërëse e strukturës administrative të SHPSHMK, të Prishtinës.
- Ndërtimi i IPF në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë:
 - IPF do të ketë tridhjetëegjashhtë shtretër prej të cilëve dymbëdhjetë shtretër do shërbejnë për ekspertizë psikiatrike ndërsa njëzetekatër shtretër për trajtimin e detyrueshëm të sëmurëve psikiatrik të cilët kanë kryer vepra penale.
 - Në IPF do të punojnë: tre psikiatër forenzik, dy psikolog të trajnuar në lëminë e psikologjisë forenzike, dy punëtor social, një administrator dhe tridhjetë infermier.

1.2.5.3.2 Pjesë funksionale të IPF, si reparte të ndara me nga gjashtë shtretër do të jenë dy njësi të psikiatrisë forenzike, pjesë të reparteve psikiatrike spitalore në Gjilan dhe në Gjakovë.

- Në këto njësi të IPF, do të punojnë nga një psikiatër, një psikolog dhe katër infermier.
- Njësia e psikiatrisë forenzike në Gjilan do të ofrojë shërbime për strukturat administrative të SHPSHMK në Ferizaj dhe në Gjilan, ndërsa njësia e psikiatrisë forenzike në Gjakovë do të ofrojë shërbime për strukturat administrative të SHPSHMK në Pejë, Prizren dhe Gjakovë.
- Përpos shërbimeve spitalore, njësitë e psikiatrisë forenzike në Gjakovë dhe në Gjilan do t'u ofrojnë konsultime rreth ekspertizave psikiatrike: prokurorisë, gjykatave, organeve të punëve të brendshme, dhe institucioneve të sigurisë.
- Çështjet e sigurisë në IPF dhe njësitë e tij të ndara, në Gjakovë dhe në Gjilan, do të realizohen në pajtim me standardet ndërkombëtare.

1.2.5.3.3 Aftësimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit të nevojshëm në këtë lëmi.

1.2.5.4 Organizimi, funksionimi dhe zhvillimi i shërbimeve të sëmundjeve të vartësisë.

1.2.5.4.1 Përpilimi i programit unik për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shërbimeve të sëmundjeve të vartësisë, me të cilin përcaktohet se:

- Niveli parësor i kujdesit për sëmundjet e vartësisë organizohet në kuadër të bashkëpunimit institucional ndërmjet SHPSHMK dhe organizatave të specializuara joqeveritare.
- Niveli dytësor i kujdesit për sëmundjet e vartësisë organizohet në kuadër të njësive me dy shtretër në kuadër të reparteve psikiatrike në spitale.
- Niveli tretësor i kujdesit për sëmundjet e vartësisë organizohet fillimisht në njësinë për sëmundje të vartësisë të Klinikës së Psikiatrisë, të QKUK, me katër shtretër ndërsa deri në fund të vitit 2013 në kuadër të Institutit për Sëmundje të Vartësisë, pjesë e SHPSHMK, me njëzet shtretër.
- Shërbimet në njësitë e lartëpërmendura për sëmundje të vartësisë do të ofrohen nga ekipet multidisiplinare të përbëra nga psikiatër, psikolog klinik, infermierë dhe punëtorë social (me trajnim të veçantë në lëminë e sëmundjeve të vartësisë).
- Programet kryesore të trajtimit të sëmundjeve të vartësisë do të jenë:
 - a) Programet detoksikuese, që në raste të "mbi dozimit" do të zbatohen në qendrat e kujdesit emergjent ndërsa në rastet e tjera në njësitë përkatëse spitalore dhe klinike;
 - b) Programet e zëvendësimit (substituimit) që do të zbatohen në Institutin për Sëmundje të Vartësisë, pjesë e SHPSHMK.

1.2.5.4.2 Aftësimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit të nevojshëm në këtë lëmi.

1.2.5.5 Integrimi, koordinimi dhe harmonizimi i shërbimeve të SHPSHMK me aktivitetet e përcaktuara në Planin Kombëtar për Trauma Psikike.

1.2.5.5.1 Integrimi i detyrave operative të Planit Kombëtar për Trauma psikike në programet e punës së shërbimeve të mjekësisë familjare dhe të njësive funksionale të SHPSHMK.

1.2.5.5.2 Zhvillimi i kapaciteteve të shërbimeve të mjekësisë familjare për të identifikuar dhe trajtuar problemet e shëndetit mendor të shkaktuara nga traumat psikike.

1.2.5.5.3 Sigurimi i qasjes multidisiplinare ndaj personave me pasoja nga traumat psikike.

- 1.2.5.5.4 Zbatimi i psikoedukimit në grupe shumëfamiljare përkitazi me traumat psikike.
- 1.2.5.5.5 Zbatimi i programeve të vetëdijësimit dhe të shfrytëzimit të fuqive vetanake nëpërmjet teknikave mendje – trup, përkitazi me pasojat e stresit dhe të traumave psikike.
- 1.2.5.5.6 Aktivitetet rreth themelimit të Qendrës Kombëtare të Ekspertizës për Trauma Psikike, në nivelin tretësor të kujdesit për shëndetin mendor, si qendër referente hulumtuese, shkencore dhe profesionale, në lëminë e traumave psikike.
- 1.2.5.6 Zhvillimi i shërbimeve të psikologjisë klinike.
- 1.2.5.7 Zbatimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mjekëve dhe infermierëve familjar, në lëminë e shëndetit mendor.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.2.5

- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për themelimin, organizimin, dhe funksionimin e shërbimit të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për themelimin, organizimin, dhe funksionimin e shërbimit të psikiatrisë forenzike.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për themelimin, organizimin, dhe funksionimin e shërbimit të sëmundjeve të vartësisë.
- Fillimi i punës së shërbimeve dhe institucioneve të lartëpërmendura, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.
- Rishikimi i planit të specializimeve në lëminë e psikiatrisë së të rriturve deri më 1 Tetor 2008.
 - Përfundimi i specializimit të pesëmbëdhjetë psikiatërve për të rritur, sipas dinamikës së përcaktuar kohore, deri në vitin 2013.
- Miratimi i planit të specializimeve në lëminë e psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve, sipas dinamikës së përcaktuar kohore, deri më 1 Tetor 2008.
- Rishikimi i programeve të specializimit në lëminë e psikiatrisë së të rriturve dhe psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve.
- Akreditimi i gjashtë psikiatërve në lëminë e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilët kanë pasur trajnime relevante në këtë lëmi, të miratuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë; deri në fund të vitit 2008.
- Specializimi i shtatë psikiatërve dhe shtatë psikologëve, në lëminë e psikologjisë së fëmijëve dhe adoleshentëve, deri në fund të vitit 2013.
- Miratimi dhe zbatimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e psikiatrisë forenzike.

- Aftësimi i pesë psikiatërve në lëminë e psikiatrisë forenzike, nga Prishtina, Gjakova dhe Gjilani, deri në fund të vitit 2008.
- Miratimi dhe zbatimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e psikiatrisë së sëmundjeve të vartësisë.
 - Aftësimi i shtatë psikiatërve në lëminë e sëmundjeve të vartësisë, deri në fund të vitit 2008.
- Zbatimi i aftësimit profesional të kuadrit të nevojshëm për shërbimet e psikiatrisë forenzike, shërbimet e sëmundjeve të vartësisë, dhe shërbimet e traumave psikike, sipas dinamikës së përcaktuar kohore, në bazë të programeve të veçanta.
- Nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Universitetit të Prishtinës, përkitazi me përkrahjen e zhvillimit universitar dhe pasuniversitar të studentëve të Mjekësisë dhe Psikologjisë, që siguron:
 - Numrin stabil dhe optimal të studentëve, në nivelin universitar dhe pas universitar të studimeve të Mjekësisë dhe të Psikologjisë, në Universitetin e Prishtinës;
 - Aftësimin praktik, profesional, të studentëve të Psikologjisë dhe të Mjekësisë, të nivelit universitar dhe pasuniversitar të studimeve në Universitetin e Prishtinës, sipas programit të caktuar universitar, në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, në shërbimet e mjekësisë familjare si dhe në programet parandaluese të SHPSHMK, që zbatohen në shkollat fillore dhe të mesme, në bazë të marrëveshjes së veçantë me MASHT; dhe
 - Mbikqyrjen adekuate profesionale të aftësimit klinik në çdonjërin prej shtatë strukturave administrative të SHPSHMK.
- Përpilimi i planit të regjistrimit të studentëve në nivelin universitar dhe pasuniversitar të studimeve në Departamentin e Psikologjisë.
- Miratimi i planit të specializimeve në lëminë e psikologjisë klinike, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.
- Miratimi dhe zbatimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e shërbimeve për trauma psikike, në bazë të Programit Kombëtar për Trauma Psikike.
 - Themelimi i qendrës kombëtare të ekspertizës për trauma psikike deri në fund të vitit 2008.
 - Zbatimi i programeve të trajnimit të shërbimeve të mjekësisë dhe infermierisë familjare në lëminë e traumave psikike.

- Zbatimi i programeve të psikoedukimit në grupe shumëfamiljare përkitazi me traumat psikike, në të gjitha qendrat e shëndetit mendor.
- Miratimi dhe zbatimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e shëndetit mendor për specialistët e mjekësisë familjare dhe infermierinë familjare.
 - Përpilimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mjekëve dhe infermierëve familjar përkitazi me kujdesin parësor të shëndetit mendor.
 - Zhvillimi i kapaciteteve të shërbimeve të mjekësisë familjare për të identifikuar dhe trajtuar çrregullimet e lehta të shëndetit mendor, përfshirë: ankthin, çrregullimet e stresit, depresionin jopsikotik, abuzimin e substancave psikoaktive dhe sëmundjet kronike psikiatrike në fazën e remisionit.
 - Përshkrimi adekuat i medikamenteve psikotrope (veçanërisht terapisë mbajtëse depo-neuroleptike) dhe zbatimi i intervenimeve psikoterapeutike suportive dhe bihejviorale te individët me çrregullime psikiatrike stabile, të cilët jetojnë në komunitet.
 - Trajnimi në teknikën e psikoedukimit në grupe shumëfamiljare, përkitazi me entitetet më të rëndësishme psikiatrike.
 - Trajnimi në teknikat mendje – trup me qëllim të vetëdijësimit të klientëve për shfrytëzimin e fuqive vetanake në ballafaqimin me çrregullimet e shëndetit mendor.
 - Përgatitja dhe zbatimi i protokoleve të trajtimit dhe të referimit të klientëve nga niveli i kujdesit parësor, duke zhvilluar praktika të mira dhe duke definuar qartë, marrëdhëniet e ndërsjella të shërbimeve të mjekësisë familjare me nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit për shëndetin mendor.
 - Trajnime për punë ekipore dhe multidisiplinare.

1.3 Rehabilitimi i suksesshëm psikosocial i shfrytëzuesve të SHPSHMK.

1.3.1 Mbështetja e procesit të deinstitutionalizimit të të sëmurëve kronik psikiatrik nga: spitalet psikiatrike jashtë Kosovës ¹², repartet psikiatrike në Klinikën e Psikiatrisë dhe spitalet rajonale, Qendra për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, dhe shtëpitë për integrim në bashkësi.

- 1.3.1.1 Qendra për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, si strukturë e veçantë administrative e SHPSHMK do të ketë dy njësi përbërëse: repartin psikiatrik me tridhjetë shtretër, që do të punojë sipas programit të veçantë; dhe qendrën rehabilituese – vokacionale të të sëmurëve kronik psikiatrik me njëzet shtretër.
- 1.3.1.2 Zbatimi i politikës së mospranimit në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, duke respektuar politikën e ruajtjes së numrit të njëjtë të shtretërve dhe zvogëlimit të tyre gradual, që nënkupton pranimin e rasteve të veçanta në bazë të vendimit të Komisionit profesional të emëruar nga Ministria e Shëndetësisë, vetëm pas resocializimit paraprak të ndonjërit prej klientëve të Qendrës nga struktura përkatëse administrative e SHPSHMK.
- 1.3.1.3 Deinstitutionalizimi i shumicës së klientëve në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, sipas dinamikës së caktuar kohore.
- 1.3.1.4 Zvogëlimi gradual i numrit të shtretërve në këtë Qendër deri në pesëdhjetë, krahas ngritjes së kapaciteteve rehabilituese dhe resocializuese.
- 1.3.1.5 Shqyrtimi i mundësisë së transferimit të klientëve jokosovar të Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime në institucionet përkatëse jasht vendit, më afër familjeve dhe komuniteteve të tyre, si dhe të pacientëve kosovar, nga institucionet psikiatrike jasht vendit, në Kosovë.
- 1.3.1.6 Rishikimi i: kritereve për pranim, programeve të rehabilitimit dhe kohëzgjatjes së qëndrimit në shtëpitë integruese në bashkësi.
- 1.3.1.7 Funkcionalizimi i Shtëpive për Integrim në: Pejë, Drenas dhe Skenderaj.
- 1.3.1.8 Ndërtimi i shtatë shtëpive të reja për integrim në bashkësi dhe punësimi i kuadrit të nevojshëm profesional, për këtë qëllim, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.
- 1.3.1.9 Zbatimi i procedurave ligjore për shfrytëzimin e pasurive të klientëve të Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime dhe të Shtëpive për integrim në bashkësi, në funksion të rehabilitimit të tyre sa më të suksesshëm psikosocial.

¹² Mendohet për pacientë kosovar që gjenden në trajtim në institucionet psikiatrike në Serbi dhe Maqedoni.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.3.1

- Nxjerrja e udhëzimit administrativ mbi organizimin dhe funksionimin e Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, përfshirë kriteret për themelimin Komisionit profesional, që do të përcaktojë politikat e pranimit dhe lëshimit nga kjo qendër.
- Zhvendosja e 30 % të klientëve në komunitet, deri në fund të vitit 2009.
- Zvogëlimi i numrit të shtretërve në pesëdhjetë, deri në fund të vitit 2009.
- Funksionalizimi i Shtëpive për Integrim në Bashkësi në: Pejë, Drenas, dhe Skenderaj, si dhe kompletimi me stafin e domosdoshëm të Shtëpive për Integrim në Bashkësi në Mitrovicë nëpërmjet punësimit urgjent të tridhjetëepesë infermierëve dhe katër punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i shtatë Shtëpive të reja për Integrim në Bashkësi dhe punësimi i katërdhjetëepesë infermierëve dhe tetë punëtorëve ndihmës për këtë qëllim.
- Emërimi i zyrtarit për çështje juridike në Sektorin e shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe inicimi i procedurave përkatëse juridike.

1.3.2 Funksionalizimi i të drejtave të sëmurëve psikiatrik në lëminë e mbrojtjes sociale.

1.3.2.1 Sigurimi i lehtësimeve ligjore për ndërmarrjet që punësojnë të sëmurët kronik mendor si pjesë të rehabilitimit psikosocial.

1.3.2.1.1 Iniciativat ligjore në nivel të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës.

1.3.2.1.2 Bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Kosovës dhe asociacionet profesionale të biznesit.

1.3.2.1.3 Bashkëpunimi institucional i SHPSHMK me ndërmarrjet ekonomike dhe organizatat relevante joqeveritare, në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.3.2

- Nxjerrja e ligjeve që rregullojnë lehtësirat financiare të ndërmarrjeve, që punësojnë të sëmurë kronik psikiatrik si pjesë e programit të rehabilitimit të tyre psikosocial.
- Miratimi i protokoleve të bashkëpunimit të SHPSHMK me Odën Ekonomike të Kosovës dhe asociacionet profesionale të biznesit.

1.3.3 Themelimi i kapaciteteve resocializuese, në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, për trajnime vokacionale dhe punësimin e të sëmurëve kronik psikiatrik, me qëllim të fuqizimit të rolit të tyre aktiv.

1.3.3.1 Zhvillimi i aktiviteteve gjeneruese në qendrën integruese të shëndetit mendor në Shtime dhe ndërtimi i bashkëpunimit me strukturat në komunitet.

1.3.3.2 Zhvillimi i aktiviteteve gjeneruese nëpërmjet kooperativave sociale dhe punëtorive, që gjenerojnë të mira materiale dhe mundësinë e punësimit në komunitet, në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.3.3

- Zbatimi i aktiviteteve gjeneruese në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.
- Themelimi i kooperativave sociale dhe punëtorive që gjenerojnë të mira materiale, në çdo strukturë administrative të SHPSHMK.
- Nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet strukturave administrative të SHPSHMK dhe ndërmarrjeve ekonomike, me qëllim të zbatimit të programeve të trajnimit vokacional dhe të punësimit të personave me sëmundje dhe çrregullime psikike.

1.3.4 Bashkëpunimi institucional ndërmjet SHPSHMK, shërbimeve të mirëqenies sociale, dhe organizatave relevante joqeveritare.

1.3.4.1 Përpilimi i Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet SHPSHMK dhe shërbimeve të mirëqenies sociale.

1.3.4.2 Përpilimi i Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet SHPSHMK dhe organizatave relevante joqeveritare, përfshirë mundësinë e finansimit të projekteve të përbashkëta të rehabilitimit psikosocial, nga mjetet buxhetore të SHPSHMK.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.3.4

- Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet SHPSHMK dhe shërbimeve të mirëqenies sociale.
- Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet SHPSHMK dhe organizatave relevante joqeveritare.

1.3.5 Programet e psikoedukimit në grupe shumëfamiljare sipas temave të caktuara.

1.3.5.1 Programet e psikoedukimit në grupe shumëfamiljare përkitazi me sëmundjet dhe çrregullimet më të rëndësishme psikiatrike, që zbatohen në qendrat kryesore të mjekësisë familjare, në qendrat e shëndetit mendor dhe në shtëpitë për integrim në bashkësi, në bazë të programeve të veçanta.

1.3.5.2 Sigurimi i ardhjes së rregulltë të familjeve në seancat e psikoedukimit.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.3.5

- Sigurimi i buxhetit për shpenzimet e transportit të anëtarëve të familjeve deri te qendrat e shëndetit mendor.
- Zbatimi i rregulltë i programit të psikoedukimit në grupe shumë-familjare.

1.4 Ngritja e kapaciteteve udhëheqëse në SHPSHMK, përfshirë udhëheqësit e proceseve të reformës në lëmitë specifike të shëndetit mendor dhe menaxherët e strukturave të veçanta administrative.

1.4.1 Planifikimi adekuat buxhetor, në bazë të parametrave relevant, me synim të zhvendosjes së shpenzimeve buxhetore nga repartet spitalore kah shërbimet e shëndetit mendor në bashkësi.

- 1.4.1.1 Planifikimi adekuat buxhetor i shpenzimeve, të domosdoshme për funksionimin adekuat të sistemit të shërbimeve të shëndetit mendor, në rrafshin e resurseve njerëzore, mallërave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale, në të tri nivelet e kujdesit për shëndetin mendor, sipas strukturave administrative të SHPSHMK.
- 1.4.1.2 Identifikimi i shërbimeve, që ofrohen në institucionet e SHPSHMK dhe përcaktimi i shpenzimeve të domosdoshme për realizimin e tyre.
- 1.4.1.3 Identifikimi i resurseve të domosdoshme njerëzore për realizimin e shërbimeve dhe mjeteve të domosdoshme për punësimin e tyre.
- 1.4.1.4 Identifikimi i prioriteteve për investime kapitale, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.
- 1.4.1.5 Plani financiar i të hyrave plotësuese të SHPSHMK, që dalin nga të drejtat pronësore të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor në shtëpitë për integrim në bashkësi dhe në qendrën integruese të shëndetit mendor në Shtime.
 - 1.4.1.5.1 Angazhimi i ekspertëve juridik për përcjelljen e procedurave përkatëse gjyqësore, të përcaktuara me ligj.
 - 1.4.1.5.2 Mobilizimi i të hyrave plotësuese financiare, në funksion të rehabilitimit psikosocial të shfrytëzuesve të shërbimeve të SHPSHMK.
- 1.4.1.6 Përcaktimi i nënkodeve buxhetore për shërbimet e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, nënkodit të repartit psikiatrik në Gjakovë, si dhe për institucionet e shëndetit mendor që ofrojnë shërbime të nivelit tretësor të kujdesit për shëndetin mendor, në kuadër të kodit buxhetor të shëndetit mendor (SHPSHMK).

1.4.2 Themelimi i Sektorit të shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe sigurimi i përgjegjësisë administrative të drejtorëve të strukturave administrative të SHPSHMK ndaj udhëheqësit të këtij sektori.

1.4.2.1 Themelimi i Sektorit të shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë.

1.4.2.2 Sigurimi i përgjegjësisë së qartë administrative, në të gjitha nivelet e organizimit të sistemit të shërbimeve të shëndetit mendor, në funksion parësor të sigurimit të kualitetit dhe vazhdimësisë së shërbimeve të shëndetit mendor, veçanërisht ndërmjet qendrave të shëndetit mendor dhe reparteve psikiatrike, klinike dhe spitalore.

1.4.3 Sigurimi i trajnimeve relevante menaxheriale për stafin udhëheqës të SHPSHMK.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.4

- Buxheti i elaboruar për çdo vit financiar, për çdo strukturë administrative, sipas prioriteteve dhe kategorive relevante shpenzuese.
- Nënkodet e përcaktuara financiare për shërbimin e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, repartin psikiatrik në Gjakovë dhe institucionet tretësore të kujdesit për shëndetin mendor.
- Ndryshimi dhe plotësimi i udhëzimit administrativ (shëndetësi) mbi administrimin dhe organizimin e shërbimit profesional të shëndetit mendor të Kosovës 1/2005, me qëllim të sigurimit të përgjegjësisë administrative të Drejtorëve të strukturave administrative të SHPSHMK ndaj Zyrtarit për Shëndet Mendor, në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Miratimi i planit për trajnimin e stafit menaxherial të SHPSHMK.

1.5 Koordinimi ndër-sektorial i shërbimeve të shëndetit mendor me shërbimet e mirëqenies sociale, shërbimet e punëve të brendshme, shërbimet gjyqësore, sistemin penal dhe korrektues, dhe shërbimet përkatëse në sektorin joqeveritar.

1.5.1 Institucionalizimi i bashkëpunimit të SHPSHMK me shërbimet jashtë sektorit të shëndetësisë:

1.5.1.1 Shërbimin e mirëqenies sociale, nëpërmjet protokolit përkatës të bashkëpunimit.

1.5.1.2 Shërbimet gjyqësore, nëpërmjet protokolit përkatës të bashkëpunimit.

1.5.1.3 Shërbimin e punëve të brendshme, nëpërmjet protokolit përkatës të bashkëpunimit.

1.5.1.4 Sistemin penal dhe korrektues, nëpërmjet protokolit përkatës të bashkëpunimit.

1.5.1.5 Universitetin e Prishtinës, nëpërmjet protokolit përkatës të bashkëpunimit.

1.5.1.6 Organizatat relevante joqeveritare dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

1.5.2 Programet e trajnimeve të përbashkëta të profesionistëve të SHPSHMK me punëtorët e shërbimeve përkatëse të mirëqenies sociale, të punëve të brendshme, të shërbimeve gjyqësore, të sistemit penal dhe korrektues, si dhe me mësimdhënësit në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.5

- Protokolet e miratuara të bashkëpunimit ndërmjet SHPSHMK dhe shërbimeve të lartëpërmendura.
- Zbatimi i programeve të trajnimeve të përbashkëta, të përcaktuara me protokolet e lartëpërmendura të bashkëpunimit.

1.6 Zhvillimi i bashkëpunimit profesional dhe shkencor me institucione vendore dhe ndërkombëtare akademike, përfshirë financimin nga buxheti i Kosovës.

1.6.1 Bashkëpunimi institucional me asociacionet profesionale dhe shkencore, vendore dhe ndërkombëtare, në sektorin qeveritar dhe joqeveritar.

1.6.1.1 Bashkëpunimi institucional me OBSH, donatorët vendor dhe ndërkombëtar, Asociacionin e Psikiatërve të Kosovës, Shoqatën e Psikologëve të Kosovës, Lidhjen e Psikiatrisë Shqiptare, Asociacionin Kosovar të Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshentëve, Shoqatën e psikoterapeutëve të Kosovës, dhe organizatat e tjera relevante, vendore dhe ndërkombëtare në sektorin joqeveritar.

1.6.2 Përcaktimi i projekteve prioritare hulumtuese në lëminë e shëndetit mendor.

1.6.2.1 Hulumtimi i shkaqeve të vetëvrasjeve të shtuara në Kosovë, pas luftës.

1.6.2.2 Hulumtimi i gjendjes së shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve në Kosovë.

1.6.2.3 Hulumtimi i trajtimit të sëmundjeve dhe të çrregullimeve të shëndetit mendor nga personat paramedical.

1.6.2.4 Unifikimi i terminologjisë psikologjike dhe psikiatrike në rrafshin mbarëkombëtar.

1.6.2.5 Propozimet për projektet hulumtuese do të shqyrtohen nga komiteti etik, që formohet në bashkëpunim me asociacionet përkatëse profesionale.

1.6.3 Mbështetja e anëtarësimit të asociacioneve profesionale vendore në asociacionet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 1.6

- Realizimi i projekteve të përbashkëta me: OBSH, donatorët vendor dhe ndërkombëtar, Asociacionin e Psikiatërve të Kosovës, Shoqatën e Psikologëve të Kosovës, Lidhjen e Psikiatrisë Shqiptare, Asociacionin Kosovar të Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshentëve, Shoqatën e psikoterapeutëve të Kosovës, dhe organizatat e tjera relevante, vendore dhe ndërkombëtare në sektorin joqeveritar.
- Shpallja e Konkursit për hulumtim nga ana e Qeverisë së Kosovës.
- Realizimi i hulumtimit mbi shkaqet e vetëvrasjeve në Kosovë (2008).
- Realizimi i hulumtimit të gjendjes së shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve në Kosovë (2009).
- Realizimi i hulumtimit i trajtimit të sëmundjeve dhe të çrregullimeve të shëndetit mendor nga personat paramedical në Kosovë (2010).
- Realizimi i projektit të unifikimit të terminologjisë psikologjike dhe psikiatrike në rrafshin mbarëkombëtar (2013).
- Themelimi i Komisionit etik në bashkëpunim me asociacionet përkatëse profesionale.
- Anëtarësimi i asociacioneve profesionale vendore në asociacionet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare.

2.1 Zhvillimi i shërbimit për mbledhjen, analizën dhe raportimin e rregulltë të të dhënave statistikore përkritazi me funksionimin e SHPSHMK, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

- 2.1.1 Instalimi i sistemit elektronik të mbledhjes së të dhënave në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, pjesë e sistemit të unifikuar të informimit shëndetësor.
- 2.1.2 Përgatitja e formularit të veçantë për mbledhjen e të dhënave në SHPSHMK.
- 2.1.3 Përgatitja e sistemit të raportimit të rregulltë të të dhënave në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), çdo muaj.
- 2.1.4 Themelimi i sistemit të analizës së të dhënave në IKSHPK dhe raportimi i tyre i rregulltë, çdo tre muaj, në Zyren e Shëndetit Mendor, të Ministrisë së Shëndetësisë.
- 2.1.5 Përgatitja e raportit vjetor të IKSHPK mbi gjendjen e shëndetit mendor të popullatës së Kosovës dhe mbi shërbimet e ofruara nga SHPSHMK.

2.2 Vlerësimi i shërbimeve të SHPSHMK nga Ministria e Shëndetësisë si dhe nga organizatat relevante joqeveritare dhe anëtarët e shoqërisë civile, që kujdesen për mirëqenien e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 2

- Sistemi funksional, elektronik, i mbledhjes së të dhënave në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, si pjesë e sistemit të unifikuar të informimit shëndetësor.
- Formulari i miratuar për mbledhjen e të dhënave në SHPSHMK.
- Raportimi i rregulltë i të dhënave në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), çdo muaj.
- Analiza e të dhënave në IKShPK dhe raportimi i tyre i rregulltë, çdo tre muaj, në Zyrën e Shëndetit Mendor të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësime zyrtare të shërbimeve të SHPSHMK nga Ministria e Shëndetësisë si dhe nga organizatat relevante joqeveritare, që kujdesen për mirëqenien e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

3.1 Përgatitja e Ligjit të Shëndetit Mendor të Kosovës.

3.1.1 Përgatitja e Memorandumit shpjegues për arsyeshmërinë e nxjerrjes së Ligjit të shëndetit mendor.

3.2 Monitorimi i respektimit të të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendorë; të dinjitetit, të autonomisë dhe të mëvetësisë së tyre.

3.2.1 Themelimi dhe funksionalizimi i Bordit për të Drejtat e Njeriut të të Sëmurëve Psikiatrik, në nivel të Zyrës së Shëndetit Mendor të Ministrisë së Shëndetësisë.

3.2.2 Raportimi i rregulltë i institucioneve të SHPSHMK mbi shkeljet eventuale të të drejtave të njeriut të të sëmurëve psikiatrik, në bazë të formularit të veçantë, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

3.2.3 Përpilimi i aktit përkatës nënligjor.

3.3 Bashkëpunimi institucional me Zyren për Qeverisje të Mirë në Qeverinë e Kosovës dhe institucionin e Ombudspersonit të Kosovës.

3.4 Bashkëpunimi i SHPSHMK me organizatat joqeveritare në lëminë e mbikqyrjes së të drejtave të të sëmurëve psikiatrik përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve.

3.4.1 Përgatitja e protokollit të bashkëpunimit me organizatat relevante joqeveritare.

3.5 Sigurimi i funksionalitetit të plotë të SHPSHMK.

Indikatorët e përmbushjes së objektivit 3

- Miratimi i Ligjit të Shëndetit Mendor të Kosovës.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (shëndetësi) 1/2005, që do të rregullojë çështjet, si vijon:
 - Sigurimi i përgjegjësive administrative të Drejtorëve të strukturave administrative të SHPSHMK ndaj udhëheqësit të sektorit për Shëndet Mendor, në Ministrinë e Shëndetësisë.
 - Bashkëpunimi me Drejtoritë komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
 - Integrimi administrativ i reparteve psikiatrike (spitalore dhe klinike) në kuadër të strukturës përkatëse administrative të SHPSHMK deri në fund të vitit 2013, dhe ndryshimi i statuteve të spitaleve dhe Statutit të Klinikës së Psikiatrisë, të QKUK, për këtë qëllim. Fillimisht do të zbatohet pilot projekti për integrimin e repartit psikiatrik në spitalin e Gjakovës.
 - Zyrtarizimi i programeve unike të trajtimit dhe të rehabilitimit psikosocial, të bazuara në të dhëna shkencore, të propozuara nga asociacionet relevante profesionale të vendit dhe të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
 - Themelimi, organizimi, dhe funksionimi i shërbimit të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë, përfshirë sigurimin e hapësirës punuese për shërbimet e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, në qendrat kryesore të mjekësisë familjare.
 - Themelimi, organizimi, dhe funksionimi i shërbimit të psikiatrisë forenzike.
 - Themelimi, organizimi, dhe funksionimi i shërbimit të sëmundjeve të vartësisë.
 - Organizimi dhe funksionimi i qendrës integruese të shëndetit mendor në Shtime.
 - Emërimi i anëtarëve të Bordit për të drejtat e të sëmurëve psikiatrik.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë, përkitazi me mundësimin e shfrytëzimit të të drejtave pronësore të klientëve, të vendosur në shtëpitë për integrim në bashkësi dhe në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ mbi regjistrimin e individëve, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.

- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, MASHT, Universitetit të Prishtinës, dhe Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sportit:
 - Zbatimi i programeve parandaluese në shkolla;
 - Sigurimi i punësimit të psikologëve klinik në shkollat publike, fillore dhe të mesme;
 - Sigurimi i politikës adekuate të regjistrimit në Fakultetin e Mjekësisë dhe Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës.
 - Sigurimi i punës kualitative praktike të studentëve të mjekësisë dhe psikologjisë, në kuadër të strukturave administrative të SHPSHMK.
- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe organizatave relevante joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, veçanërisht me ata që janë aktiv, në lëminë e mbikqyrjes së të drejtave të sëmurëve psikiatrik.
- Përpilimi i protokolit të bashkëpunimit me qendrat komunale për punë sociale.
- Përpilimi i protokolit të bashkëpunimit me institucionet komunale të shërbimit të punëve të brendshme.
- Përpilimi i Memorandumit të bashkëpunimit me institucionet e sigurisë.
- Përpilimi i Protokolit të bashkëpunimit me institucionet përkatëse të gjyqësorit dhe të sistemit penal korrektues.
- Miratimi i protokoleve të referimit nga shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet e mirëqenies sociale, organizatat relevante joqeveritare dhe individët e regjistruar, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor, në strukturat përkatëse administrative të SHPSHMK.
- Miratimi i protokolit të referimit në institucionet e nivelit tretësor të kujdesit.
- Nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet SHPSHMK, Odës Ekonomike të Kosovës dhe asociacionet profesionale të biznesit, përfshirë miratimin e protokoleve të bashkëpunimit të strukturave administrative të SHPSHMK dhe ndërmarrjeve ekonomike, me qëllim të zbatimit të programeve të trajnimit vokacional dhe të punësimit të personave me sëmundje dhe çrregullime psikike.
- Përpilimi i formularit për paraqitjen e shkeljes së të drejtave të të sëmurëve psikiatrik.

PRIORITETET 2008

Prioritetet e strategjisë sipas aktiviteteve, të përcaktuara për vitin 2008, janë:

- Organizimi i dy tryezave të debatit, me përfaqësues të bashkësive relevante fetare.
- Organizimi i tryezave të rregullta mujore të koordinimit të organizatave joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, që zhvillojnë aktivitetete në lëminë e shëndetit mendor, në territorin përkatës.
- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe organizatave relevante joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, veçanërisht me ata që janë aktiv, në lëminë e mbikqyrjes së të drejtave të sëmurëve psikiatrik.
- Miratimi i protokoleve të bashkëpunimit me qendrat komunale për punë sociale, njësitë përkatëse të shërbimeve të punëve të brendshme, njësitë përkatëse të institucioneve të sigurisë, dhe institucionet përkatëse të gjyqësorit dhe të sistemit penal korrektues.
- Nënshkrimi i Memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse territoriale të SHPSHMK dhe Drejtorive komunale të shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale.
- Miratimi i protokoleve të referimit nga shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet e mirëqenies sociale, dhe organizatat relevante joqeveritare që ofrojnë shërbime në lëminë e shëndetit mendor, në strukturat përkatëse administrative të SHPSHMK.
- Zbatimi i programeve të psikoedukimit në grupe shumëfamiljare përkitazi me traumat psikike dhe entitet e tjera relevante psikiatrike, në të gjitha qendrat e shëndetit mendor, përfshirë sigurimin e buxhetit për shpenzimet e transportit të anëtarëve të familjeve deri te qendrat e shëndetit mendor, me qëllim të zbatimit të rregulltë të programit të psikoedukimit në grupe shumë-familjare.
- Zbatimi i programeve të vetëdijësisë dhe të shfrytëzimit të fuqive vetanake nëpërmjet teknikave mendje – trup, në të gjitha qendrat e shëndetit mendor.
- Deinstitutionalizimi i klientëve në komunitet dhe zvogëlimi gradual i numrit të shtretërve në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.
- Zbatimi i dispozitave përkatëse ligjore përkitazi me mundësimin e shfrytëzimit të të drejtave pronësore të klientëve, të vendosur në shtëpitë për integrim në bashkësi dhe në qendrën integruese të shëndetit mendor në Shtime.
- Vënja në funksion e shtëpive për integrim në bashkësi në: Pejë, Drenas, dhe Skenderaj, dhe kompletimi me stafin e domosdoshëm të shtëpive për integrim në bashkësi në Mitrovicë, nëpërmjet punësimit urgjent të tridhjetëepesë infermierëve dhe katër punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Fillimi i punës së qendrës së shëndetit mendor në Podujevë.
- Ndërtimi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.
- Zgjedhja e projektit të Institutit për sëmundje të vartësisë.
- Zbatimi i planit të specializimeve në lëminë e psikiatrisë së të rriturve, sipas dinamikës së përcaktuar kohore, nga Ministria e Shëndetësisë.
- Fillimi i specializimit të pesëmbëdhjetë psikiatërve të rinjë për të rritur.

- Miratimi i planit të specializimeve në lëminë e psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.
- Akreditimi i gjashtë psikiatërve të fëmijëve dhe adoleshentëve.
- Fillimi i specializimit të shtatë psikiatërve të fëmijëve dhe adoleshentëve.
- Aftësimi i pesë psikiatërve në lëminë e psikiatrisë forenzike (Prishtinë, Gjakovë, Gjilan).
- Aftësimi i shtatë psikiatërve në lëminë e sëmundjeve të vartësisë.
- Miratimi i planit të specializimeve në lëminë e psikologjisë.
- Buxheti i elaboruar për vitin financiar 2009, për çdo strukturë administrative, sipas prioriteteve dhe kategorive relevante shpenzuese.
- Nënkodet e përcaktuara financiare për shërbimin e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, repartin psikiatrik në spitalin e Gjakovës dhe institucionet tretësore të kujdesit për shëndetin mendor.
- Vendimet relevante të organeve gjyqësore, përkitazi me shfrytëzimin e pasurisë së shfrytëzuesve të shërbimeve të SHPSHMK në shtëpitë për integrim në bashkësi dhe në qendrën integruese të shëndetit mendor në Kosovë.
- Miratimi i planit për trajnimin e stafit menaxherial të SHPSHMK.
- Formimi i Komisionit për Ligjin e Shëndetit Mendor, nga ana e Qeverisë së Kosovës.
- Emërimi i anëtarëve të Bordit për të Drejtat e Njeriut të të Sëmurëve Psikiatrik dhe raportimi i rregulltë mbi shkeljet eventuale të të drejtave të njeriut të të sëmurëve psikiatrik, në bazë të formularit të veçantë, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.
- Realizimi i projekteve të përbashkëta me: OBSH, donatorët vendor dhe ndërkombëtar, Asociacionin e Psikiatërve të Kosovës, Shoqatën e Psikologëve të Kosovës, Lidhjen e Psikiatrisë Shqiptare, Asociacionin Kosovar të Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoloshentëve, Shoqatën e psikoterapeutëve të Kosovës, dhe organizatat e tjera relevante, vendore dhe ndërkombëtare në sektorin joqeveritar.
- Shpallja e Konkursit nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe realizimi i hulumtimit mbi shkaqet e vetëvrasjeve në Kosovë.
- Anëtarësimi i asociacioneve profesionale vendore në asociacionet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare.
- Themelimi i Komisionit etik për shqyrtimin e propozimeve për projektet hulumtuese, në bashkëpunim me asociacionet profesionale të psikiatërve dhe të psikologëve.
- Themelimi i sistemit funksional elektronik të mbledhjes së të dhënave në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, si pjesë e sistemit të unifikuar të informimit shëndetësor.
- Miratimi i formularit për mbledhjen e të dhënave në SHPSHMK.
- Raportimi i rregulltë i të dhënave në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), çdo muaj.
- Analiza e të dhënave në IKSHPK dhe raportimi i tyre i rregulltë, çdo tre muaj, në Zyren e Shëndetit Mendor të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësime zyrtare të shërbimeve të SHPSHMK nga Ministria e Shëndetësisë si dhe nga organizatat relevante joqeveritare, që kujdesen për mirëqenien e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

PRIORITETET 2009

Prioritetet e strategjisë sipas aktiviteteve, të përcaktuara për vitin 2009, janë:

- Themelimi i qendrës kombëtare të ekspertizës për trauma psikike, në bazë të Programit Kombëtar për Trauma Psikike.
- Themelimi i repartit psikiatrik në Mitrovicë, më njësitë përbërëse.
- Nxjerrja e udhëzimit administrativ mbi regjistrimin e individëve, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.
- Miratimi i protokoleve të referimit nga individët e regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor, në strukturat përkatëse administrative të SHPSHMK.
- Zbatimi i Ligjit të shëndetit mendor të Kosovës, të akteve nënligjore, të memorandumëve të bashkëpunimit, dhe të protokoleve, në fuqi.
- Dy aktivitete, të realizuara nga SHPSHMK, në çdo shkollë fillore dhe të mesme të territorit përkatës, në bazë të programit paraprakisht të miratuar nga MAShT.
- Botimi i publikimeve didaktike, tre-mujore (fletëpalosje) dhe gjashtë-mujore (revistë), përkritazi me parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve psikiatrike.
- Organizimi i dy tryezave të debatit, me përfaqësues të bashkësive relevante fetare.
- Organizimi i dy tryezave të debatit, me përfaqësues të individëve të regjistruar, që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor.
- Zbatimi i rregulltë i programit të psikoedukimit në grupe shumë-familjare dhe sigurimi i buxhetit për shpenzimet e transportit të anëtarëve të familjeve deri te qendrat e shëndetit mendor.
- Zbatimi i programeve të vetëdijësimit dhe të shfrytëzimit të fuqive vetanake nëpërmjet teknikave mendje – trup, në të gjitha qendrat e shëndetit mendor.
- Zhvendosja e 30 % të klientëve në komunitet (zvogëlimi gradual i numrit të shtretërve).
- Zbatimi i ligjeve që rregullojnë lehtësirat financiare të ndërmarrjeve, që punësojnë të sëmurë psikiatrik si pjesë e programit të rehabilitimit të tyre psikosocial.
- Zbatimi i aktiviteteve gjeneruese në qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.
- Ndërtimi i dy qendrave të shëndetit mendor dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve, dy psikiatërve, dy psikologëve dhe katër punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i dy shtëpive për integrim në bashkësi dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i një qendre të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe punësimi i një psikiatri të fëmijëve dhe adoleshentëve, një psikologu klinik, një punëtori social, katër infermierëve, dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Paguesa e rregulltë e mbikqyrësve klinik të studentëve të mjekësisë dhe të psikologjisë, në çdo strukturë administrative të SHPSHMK.
- Buxheti i elaboruar për vitin financiar 2011, për çdo strukturë administrative, sipas prioriteteve dhe kategorive relevante shpenzuese.

PRIORITETET 2010

Prioritetet e strategjisë sipas aktiviteteve të përcaktuara, për vitin 2010, janë:

- Miratimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e shëndetit mendor për specialistët e mjekësisë familjare.
- Miratimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e psikiatrisë forenzike.
- Miratimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e sëmundjeve të vartësisë.
- Miratimi i planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëminë e traumave psikike.
- Themelimi i kooperativave sociale dhe punëtorive që gjenerojnë të mira materiale, në çdo strukturë administrative të SHPSHMK.
- Miratimi i protokoleve të trajtimit dhe të rehabilitimit psikosocial, sipas entiteteve të veçanta klinike, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Zhvendosja e 20 % të klientëve të mbetur në komunitet (zvogëlimi gradual i numrit të shtretërve).
- Ndërtimi i një qendre të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe punësimi i një psikiatri të fëmijëve dhe adoleshentëve, një psikologu klinik, një punëtor social, katër infermierëve, dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i dy qendrave të shëndetit mendor dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve, dy psikiatërve, dy psikologëve dhe katër punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i dy shtëpive për integrim në bashkësi dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Pagesa e rregulltë e mbikqyrësve klinik të studentëve të mjekësisë dhe të psikologjisë, në çdo strukturë administrative të SHPSHMK.
- Buxheti i elaboruar për vitin financiar 2011, për çdo strukturë administrative, sipas prioriteteve dhe kategorive relevante shpenzuese.

PRIORITETET 2011

Prioritetet e strategjisë sipas aktiviteteve të përcaktuara, për vitin 2011, janë:

- Zhvendosja e 20 % të klientëve të mbetur në komunitet (zvogëlimi gradual i numrit të shtretërve).
- Ndërtimi i dy qendrave të shëndetit mendor dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve, dy psikiatërve, dy psikologëve dhe katër punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i dy shtëpive për integrim në bashkësi dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i një qendre të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe punësimi i një psikiatri të fëmijëve dhe adoleshentëve, një psikologu klinik, një punëtor social, katër infermierëve, dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Buxheti i elaboruar për vitin financiar 2012, për çdo strukturë administrative, sipas prioriteteve dhe kategorive relevante shpenzuese.

PRIORITETET 2012

Prioritetet e strategjisë sipas aktiviteteve të përcaktuara, për vitin 2012, janë:

- Zhvendosja e 20 % të klientëve të mbetur në komunitet (zvogëlimi gradual i numrit të shtretërve).
- Ndërtimi i një qendre të shëndetit mendor dhe punësimi i nëntë infermierëve, një psikiatri, një psikologu dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i dy shtëpive për integrim në bashkësi dhe punësimi i tetëmbëdhjetë infermierëve dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Ndërtimi i një qendre të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe punësimi i një psikiatri të fëmijëve dhe adoleshentëve, një psikologu klinik, një punëtori social, katër infermierëve, dhe dy punëtorëve ndihmës, për këtë qëllim.
- Buxheti i elaboruar për vitin financiar 2013, për çdo strukturë administrative, sipas prioritetëve dhe kategorive relevante shpenzuese.

MBIKQYRJA E ZBATIMIT

Zbatimi i Planit strategjik të shëndetit mendor të Kosovës 2008 – 2013 do të mbikqyret nga Këshilli profesional i shëndetit mendor të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e shëndetit mendor dhe Zyren e politikës shëndetësore, të Ministrisë së Shëndetësisë.

Për procesin e zbatimit të këtij plani do të përgatiten raporte të rregullta, çdo gjashtë muaj, për Komisionin parlamentar të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Ministrin e Shëndetësisë dhe Kryeministrin e Kosovës.

Partner bashkëpunues gjatë procesit të zbatimit të këtij plani strategjik do të jetë Organizata Botërore e Shëndetësisë si dhe organizatat e tjera të interesuara, vendore dhe ndërkombëtare.

BUXHETI

Për çdo vit të planit strategjik është përgatitur buxheti sipas kategorive të pagave dhe mëditjeve, mallërave dhe shërbimeve, si dhe investimeve kapitale. Llogaritja e nevojave buxhetore është bërë në bazë të shërbimeve që ofrohen në njësitë funksionale të strukturave administrative të SHPSHMK (Shtojca 2), si dhe objektivave të përcaktuara me këtë plan strategjik, sipas dinamikës së përcaktuar kohore.

SHTOJCA 1

Standardet e Shërbimit të Shëndetit Mendor të Kosovës

Parimet themelore:

- Zhvendosja e shërbimeve të shëndetit mendor nga institucionet klinike dhe spitalore në shërbime të bazuara në komunitet duke shfrytëzuar si mbështetje themelore familjen dhe rrjetin shoqëror të klientit.
- Mbështetja e punës multidisciplinare.
- Puna me bashkësinë e gjërë përfshirë shoqërinë civile drejtë minimizimit të paragjytimeve ndaj sëmundjeve dhe çrregullimeve të rënda psikiatrike.
- Përmirësimi i politikave sociale (strehimi, punësimi, aftësimi) në funksion të përmirësimit të rehabilitimit psikosocial të personave me probleme të shëndetit mendor.
- Shërbime kualitative të shëndetit mendor duke rrespektuar gjendjen fizike, psikike, shpirtërore dhe sociale të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.
- Participimi aktiv i bashkësisë së gjërë në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.

Standardi 1: Të drejtat

- Profesionistët e shërbimeve të shëndetit mendor duhet të rrespektojnë me përpikëri ligjet, rregulloret dhe aktet relevante nënligjore, që mbrojnë të drejtat e personave me sëmundje dhe çrregullime mendore.
- Shfrytëzuesve të shërbimeve dhe përkujdesësve të tyre duhet t'u ofrohet informata verbale dhe e shkruar mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre; deklarata duhet të jetë e kuptueshme dhe në gjuhë të ndryshme.

Standardi 2: Praktika e bazuar në fakte shkencore

- Organizimi i shërbimit të shëndetit mendor; parandalimi, trajtimi dhe rehabilitimi psikosocial duhet të bazohen në praktikën e bazuar në fakte shkencore.

Standardi 3: Siguria

- Mjedisi i shërbimeve të shëndetit mendor dhe aktivitetet që zhvillohen në të janë të sigurt për shfrytëzuesit, përkujdesësit, familjet, personelin shëndetësor dhe vizitorët nga komuniteti.
- Përkrahja që ofrohet nga shërbimet e shëndetit mendor siguron që shfrytëzuesit të jenë të mbrojtur nga keqtrajtimi.
- Stafit trajnohet në vazhdimësi dhe në mënyrë sistematike për të kuptuar dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të duhur, të sigurtë dhe profesionale sjelljeve agresive dhe sjelljeve të tjera të papritura të klientëve.
- Raportet përkitazi me incidentet kritike përgatiten dhe procesohen nga udhëheqësit e shërbimeve.

Standardi 4: Pjesëmarrja e klientëve dhe përkujdesësve në shërbimet e shëndetit mendor

- Shfrytëzuesit e shërbimeve dhe përkujdesësit janë të përfshirë në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve të shëndetit mendor.
- Bordi për të Drejtat e Njeriut të të Sëmurëve Psikiatrik vlerëson në mënyrë të rregulltë respektimin e të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë.
- Shërbimet e shëndetit mendor mbështesin themelimin e grupeve vetë-ndihmëse, grupeve vetë-avokuese dhe shoqatave të shfrytëzuesve dhe të përkujdesësve.

Standardi 5: Konfidencialiteti

- Shërbimet e shëndetit mendor sigurojnë intimitetin dhe konfidencialitetin për shfrytëzuesit e shërbimeve dhe përkujdesësit e tyre nëpërmjet procedurave të caktuara me të cilat ata paraprakisht njoftohen.
- Shfrytëzuesit e shërbimeve kanë mundësinë që në mënyrë private të komunikojnë me të tjerët përveç nëse kjo është në kundërshtim me kriteret e sigurisë ose kriteret e punës klinike.
- Shfrytëzuesit e shërbimeve kanë hapësira adekuate personale për pritje, këshillim si dhe ruajtjen e gjërave private.

Standardi 6: Ndjeshmëria kulturore

- Stafi i Shërbimit të shëndetit mendor ka njohuri mbi veçoritë kulturore dhe sociale, të bashkësisë së caktuar dhe ka mirëkuptim për faktorët relevant social dhe historik, që janë të rëndësishëm për aktualitetin të saj.

Standardi 7: Integriteti

- Shërbimi i shëndetit mendor është i integruar dhe i koordinuar në mënyrë të balancuar me spektër të shërbimeve, që sigurojnë vazhdimësinë e kujdesit ndaj shfrytëzuesit.

Standardi 8: Shëndeti mendor në kujdesin parësor

- Shërbimet e shëndetit mendor duhet të jenë të inkuorpuara në kujdesin parësor ose të kenë marrëdhënie të ngushtë me praktikuesit e mjekësisë familjare.

Standardi 9: Parandalimi dhe promovimi i shëndetit mendor

- Shërbimet e shëndetit mendor promovojnë rëndësinë e shëndetit mendor dhe punojnë në vazhdimësi në reduktimin e stigmës ndaj personave me çrregullime mendore.
- Shërbimet e shëndetit mendor bashkëpunojnë me bashkësinë e caktuar, strukturat promovuese të sistemit shëndetësor si dhe organizatat e tjera relevante, për të inicuar dhe për të marrë pjesë në aktivitete të dizajnuara për të përparuar pranueshmërinë e personave me çrregullime mendore në mjedisin rrethues.

- Shërbimet e shëndetit mendor bashkëpunojnë me bashkësinë e caktuar në promovimin e parandalimit, zbulimit dhe intervenimit të hershëm ndaj sëmundjeve dhe çrregullimeve mendore si dhe në përgjithsi promovimit të shëndetit mendor.
- Shërbimet e shëndetit mendor kanë kapacitet të identifikojnë dhe t'u përgjigjen njerëzve me çrregullime dhe sëmundje mendore, sa më herët që është e mundur, përfshirë: programin specifik për intervenime në psikoza dhe hershme, kohën minimale të pritjes për vlerësim, ekzaminimin parashkollor, bashkëpunimin me shërbimet e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe ndërlidhjen me shërbimet e sistemit penal dhe të mjekësisë familjare.
- Çdo shfrytëzues i shërbimeve ndihmohet për të përpiluar planin i cili identifikon shenjat e hershme të rikthimit të sëmundjes ose të çrregullimit (relapsit) si dhe ndërmarrjen e masave të duhura.
- Shërbimi i shëndetit mendor u ofron shfrytëzuesve qasje në programe të rehabilitimit psikosocial, që përmirësojnë aftësitë e klientit për vet-kujdesje; aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme për të arritur një jetë të pavarur nëpërmjet mësimin të aftësive themelore të jetesës së përditshme; aftësive të marrëdhënieve shoqërore, shkathtësive për aktivitete manuale dhe të shprehurit (pikturë, teatër, muzikë, aktivitete sportive) si dhe sjellje të shëndetshme (duhani, ushqimi, edukimi seksual); në përgjithësi promovimin e jetës së shëndoshë.
- Zhvillimi i aktiviteteve që synojnë mundësinë e përkrahjes së klientëve në trajnim, edukim, punë dhe punësim.
- Zhvillimi i aktiviteteve risocializuese si: aktivitetet joformale grupore, aktivitetet rekreative, aktivitetet e fundjavës, festat, si dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit siç janë teatri, kino, stadiumet, dyqanet dhe shërbimet.
- Shërbimet e shëndetit mendor ofrojnë programe psiko-edukative të familjes dhe klientit të cilat ju mundësojnë, njohuri dhe informacion, strategji të ballafaqimit, mbështetje familjare në lidhje me problemet emocionale dhe të bashkëjetesës, mbështetje në zhvillimin e vetë organizimit dhe grupeve të vetë – ndihmës.

Standardi 10: Trajtimi

- Shërbimet e shëndetit mendor sigurojnë që klientët dhe familjet e tyre të kenë qasje në programet e trajtimit dhe mbështetjes me orientim-familjar, përfshirë vizitat e rregullta shtëpiake ku ofrohet trajtim, përkrahje, vlerësim dhe këshillim.
- Trajtimi psikofarmakologjik: shërbimet e shëndetit mendor ofrojnë përshkrimin e barnave psikotrope, në përputhje me ligjin dhe udhëzimet ndërkombëtare; ekziston lista themelore e barnave psikotrope; siguron medikamente të sigurta, të efektshme dhe të përshtatshme; klientëve dhe përkujdesësve të tyre u ofrohet informacion i kuptueshëm në lidhje me dobitë potenciale, efektet anësore, çmimet dhe mundësitë e zgjedhjes përkitazi me barnat psikotrope; shërbimi i shëndetit mendor ka mekanizmin për menaxhimin dhe monitorimin e barnave psikotrope e veqanarisht të atyre barnave me veprim afatgjatë.

- Psikoterapia: shërbimet e shëndetit mendor ofrojnë një varg të gjërë dhe fleksibil të intervenimeve dhe të aktiviteteve të sigurta psikoterapeutike me bazë të verifikuar shkencore si: metodat grupore dhe individuale, terapitë mbështetëse psikoterapeutike, terapitë me orientim-familjar etj.
- Terapitë e ofruara nga shërbimet e shëndetit mendor reflektojnë të arriturat më bashkëkohore shkencore në dispozicion dhe zbatohen nga ana e profesionistëve të kualifikuar dhe me përvojë të shëndetit Mendor.
- Vizita e parë e hollësishme nga ana e psikiatrit ose psikologut do të duhej të zgjaste 40 minuta ndërsa vizitat pasuese së paku 15 minuta.
- Suksesi i klientëve që janë nën përkujdesje rivlerësohet në bazë periodike.

Standardi 11: Puna ekipore

- Stafi i shërbimeve të shëndetit mendor është shumë-disciplinar (psikiatri, psikologu klinik, infermierët psikiatrik, punëtorët social, terapistët e punës, këshilltarët psikosocial, edukatorët dhe profile të ngjashme), dhe vepron në pajtim me parimet e punës ekipore.
- Në ekipin shumë-disciplinar përgjegjësia është e të gjithëve dhe e bazuar në përkrahimin e detyrave të punës; ekipi mban takime të rregullta (së paku javore) mbi rastet konkrete dhe programet në të cilët është i ftuar që të marr pjesë i tërë stafi. Stafi ka mundësinë për diskutim me udhëheqësit për vështirësitë që kanë në punën me klientë si dhe punën me kolegët e tyre.

Standardi 12: Bashkëpunimi ndër-sektorial

Shërbimet e shëndetit mendor zhvillojnë dhe mirëmbajnë lidhjet me shërbimet e tjera brenda sektorit të shëndetësisë (qendrat kryesore të mjekësisë familjare, spitalet e përgjithshme), dhe jasht tij si: shërbimet sociale, zyret e punësimit, shërbimet e strehimit, përfshirë strehimin residencial (shtëpitë e pleqëve etj), shërbimin Policor dhe sistemin penal, për të siguruar kujdes të koordinuar për personat me sëmundje dhe çrregullime të shëndetit mendor. Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së bashkëpunimit këto marrëdhënie rregullohen me udhëzime, protokole dhe memorandume, të cilat i përpilon shërbimi i shëndetit mendor.

Standardi 13: Trajnimi

- Shërbimet e shëndetit mendor, në mënyrë aktive dhe të rregullt (çdo vit), identifikojnë nevojat për trajnimin e stafit dhe atë duke u bazuar në të arriturat shkencore dhe mjekësin e bazuar në fakte.
- Shërbimet e shëndetit mendor sigurojnë pjesëmarrjen e çdo anëtari të stafit në programe të edukimit dhe të zhvillimit profesional (aktivitete trajnuese ose të mbikqyrjes), në kohëzgjatje prej së paku 10 % të kohës së punës.
- Anëtarëve të ri të stafit u ofrohet programi i orientimit përkitazi me shërbimet e shëndetit mendor, me ç'rast i gjithë personeli ka mundësi diskutimi me udhëheqësit e tyre për vështirësitë që ata mund të kenë gjatë aktiviteteve të tyre ditore me klientët por edhe me kolegët.
- Shfrytëzuesit e shërbimeve dhe përkujdesësit janë të inkuadruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në trajnimin e stafit.

Standardi 14: Shërbimi psikiatrik në spitalet rajonale dhe QKUK-së

- Menaxhuesit e sistemit shëndetësor ndajnë dhe raportojnë pjesën e buxhetit vjetor të shërbimeve të shëndetit mendor të përcaktuar për shërbimin psikiatrik në spital ose Klinikën e Psikiatrisë të QKUK.
- Shërbimet shëndetit mendor ofrojnë alternativa më pak kufizuese për trajtimin e klientëve të hospitalizuar dhe bëjnë çdo përpjekje për të promovuar hospitalizimin vullnetar për klientin nëpërmjet rregulloreve përkatëse.
- Shërbimet shëndetit mendor sigurojnë vazhdimësinë e kujdesit në mes të klientëve të brendshëm – të hospitalizuar dhe kujdesit për ta në bashkësi – komunitet.
- Shërbimet psikiatrike në spitale dhe QKUK, zbatojnë sistem të përforcuar të përcjelljes së klientit pas lëshimit në bashkëpunim me shërbimet e shëndetit mendor në bashkësi dhe kujdesin shëndetësor parësor.
- Menaxhuesi i rastit (punëtori i shëndetit mendor përgjegjës për klientin konkret) është i përfshirë në planifikimin e pranimit, trajtimit dhe lëshimit të tij.
- Është zhvilluar politika e dyerve të hapura që nënkupton pranimin dhe lëshimin e klientit në bazë të marrëveshjes paraprake, me shkrim.
- Monitorohet shkalla e vetëvrasjeve (raportohet shkalla e vetëvrasjeve në 100.000 banorë).
- Aktiviteti i spitalit është i organizuar në baza territoriale dhe përcjellë organizimin territorial të shërbimeve të shëndetit mendor.
- Monitorohet shëndeti i përgjithshëm i klientëve të brendshëm dhe kujdesi nga infermierët është adekuat.

Standardi 15: Shërbimi i emergjencës

- Ekipet emergjente psikiatrike janë të organizuara përbrenda shërbimit të përgjithshëm të kujdesit psikiatrik.
- Shërbimi emergjent i shëndetit mendor në bashkësi duhet të ekzistojë në mënyrë të ndarë si një formë alternative për rastet emergjente psikiatrike në bashkësi.
- Qasja ndaj këtyre shërbimeve duhet të jetë e lehtë prandaj ato duhet të jenë të vendosura në lokacion të përshtatshëm.
- Zona e përfshirjes korrespondon me organizimin territorial të shërbimeve të shëndetit mendor.
- Indikatorët e këtij standardi përfshijnë parametrat, si vijon:
 - hapësira (shtrirja e e zonës, struktura-disponueshmëria e shtretërve-numri);
 - ekipi (numri total i anëtarëve dhe strukturës së ekipit, sipas kualifikimit profesional, moshës, gjinisë);
 - orët e punës (gjatë ditës, gjatë javës);
 - disponueshmërin e ekipeve mobile;
 - numri mesatar i intervenimeve emergjente (në ditë, në muaj);
 - sëmundshmëria;

- llojet e intervenimeve;
- disponueshmëria e linjave telefonike për personat në krizë;
- bashkëpunimi me strukturat tjera përbrenda kujdesit të shëndetit mendor;
- bashkëpunimi me policinë, anëtarët e familjes së klientit, shërbimet e mirëqenies sociale;
- njohuria përkitazi me respektimin e të drejtave njerëzore të personave me sëmundje mendore;
- problemet më të vështira gjatë ballafaqimit me çështjen e sigurisë për anëtarët e ekipit.

Standardi 16: Qendra e Shëndetit Mendor në Bashkësi (QSHMB)

- Shërbimet e shëndetit mendor në territorin e caktuar mbajnë përgjegjësi për të gjitha nevojat e popullatës për shëndetin mendor në zonën përfshirëse, të definuar në bazë të organizimit territorial të shërbimeve të shëndetit mendor; bashkësia e atij territori ka qasje të plotë në shërbimet e shëndetit mendor ndërsa vazhdimësia e kujdesit mundësohet përmes modaliteteve të ndryshme të shërbimeve.
- Shërbimi i shëndetit mendor të QSHMB organizon intervenime gjatë krizave, trajnimin për aftësitë themelore të jetesës, mbikqyrjen rreth përdorimit të medikamenteve, asistencë në aktivitetet e jetës së përditshme, vizitat shtëpiake kur është nevoja, kujdes mobil (të lëvizshëm) dhe emergjent, duke përfshirë edhe shërbime të veçanta për grupet e marginalizuara, shërbime specifike për moshën të caktuar; dhe qasje 24-orëshe në shërbimet e shëndetit mendor (në bashkëpunim me repartin psikiatrik).
- Shërbimet e shëndetit mendor ofrojnë spektër të gjërë të shërbimeve: kujdes ditor, vizita shtëpiake.
- Sistemi i referimit është jo-burokratik: me renditje paraprake mjekësore, vet-referim, caktimit përmes telefonit, ardhjes direkte, etj.
- Shërbimi i pranimit është i organizuar për të ndihmuar shfrytëzuesit që të hyjnë në shërbimin e shëndetit mendor. Staf i kualifikuar dhe me përvojë i shërbimeve të shëndetit mendor është në dispozicion gjatë tërë kohës për të ofruar informacion dhe asistencë.
- Shërbimet e shëndetit mendor janë lehtë të arritshme me transport publik nga çfarëdo lokacioni në zonë.
- Qasja në shërbimet e shëndetit mendor në QSHMB është e lehtë në aspekt të orëve të hapjes (pika qendrore e Shërbimit duhet të punojë se paku 9 orë në ditë dhe 5 ditë në javë, sido që shërbimi gjatë fundjavës është i ofruar.
- Lista e rendit për pritje lidhur me vizitën e parë të hollësishme (pa urgjencë) është e kufizuar.
- Koha e pritjes nga lajmërimi i urgjencës gjer te vizita është e përshtatshme.
- Koha e pritjes ndërmjet orarit fiks të caktuar dhe vizitës është adekuate (se paku brenda 30 minutave).
- Koha e pritjes ndërmjet të kuptuarit të nevojës dhe vizitës shtëpiake duhet të jetë i kufizuar (asnjëherë më shumë se 7 ditë).
- Informacioni mbi shërbimet është në dispozicion për komunitetin dhe shfrytëzuesit (fletushkat, posterët etj.).

- Personeli mjekësor është gjithnjë prezent duke garantuar prezencën e profileve të ndryshme profesionale.
- QSHMB, në mënyrë të rregullt bën grumbullimin e të dhënave epidemiologjike në zonën e vet të përfshirjes.
- Shërbimi i shëndetit mendor të QSHMB ka financim të parashikuar dhe të sigurtë.
- QSHMB është e hapur ndaj bashkësisë duke përdorë edhe burimet ekzistuese në shoqëri, përfshirë trajnimet profesionale, programet rekreative, dhe aktivitete të tjera që nuk janë ngusht aktivitete të shëndetit mendor si trajnime të ndryshme, ekspozita artistike, program muzikor, etj.
- Në QSHMB në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë dhe Gjakovë është e punësuar struktura e njejtë, kualitative dhe kuantitative, profesionale, si vijon:
 - 2 Psikiatër;
 - 2 Psikolog;
 - 2 Këshilltar psikosocial;
 - 12 Infermier;
 - 3 Roje;
 - 1 Pastrues;
 - 1 Vozitës;
 - 1 Administrator ekonomik dhe juridik;
 - 2 Punëtor social – një punëtor social të parashihet në buxhet prej vitit 2009.
- QSHMB në Skenderaj dhe Podujevë, janë njësi funksionale të SHPSHM të Mitrovicës (Skenderaj) dhe Prishtinës (Podujeva) dhe në to është e punësuar struktura, kualitative dhe kuantitative, profesionale, si vijon¹³:
 - 1 Psikiatër;
 - 1 Psikolog;
 - 4 Infermier;
 - 1 Pastrues;
 - 1 Punëtor social – prej vitit 2009.
- Përbërja e stafit dhe parimet e punës ekipore, përfshijnë indikatorët, si vijon:
 - numri i përgjithshëm i anëtarëve të ekipit;
 - struktura sipas përkatësisë profesionale, gjinore, moshës etj.
 - jo më pak se 50 % e stafit të punësuar duhet të jetë i dedikuar për aktivitete të jashtme (vizita shtëpiake, aktivitete të formimit të rrjetës sociale në mjedisin rrethues dhe bashkpunimin me shërbime të tjera);
 - numri i shtretërve në disponim;
 - numri i ekipeve mobile (lëvizëse) në disponim;
 - numri i shërbimeve emergjente;
 - numri mesatar i vizitave shtëpiake (në ditë, në muaj);
 - numri mesatar i trajtimeve shtëpiake të klientëve (në ditë, në muaj);
 - numri mesatar i klientëve (në ditë, në muaj);

¹³ Në këtë numër është i përfshirë edhe Udhëheqësi i QSHMB.

- numri mesatar i intervenimeve emergjente (në ditë, në muaj);
- pajisjet (vetura, kompjuterë);
- specifikimi i aktiviteteve terapeutike sipas strukturës profesionale (psikiatër, psikolog, punëtor social, këshilltarë psikosocial, infermier);
- specifikimi i trajtimit me medikamente, psikoterapi, kombinimet e të dyjave;
- bashkëpunimi me shërbimet e kujdesit parësor;
- bashkëpunimi me shërbimet e mirëqenies sociale;
- kyçja në aktivitete të parandalimit-promovimit në komunitet;
- kyçja në aktivitete edukative (të rregullta; jo të rregullta; të specifikohet lloji i edukimit);
- numri mesatar i trajtimeve për çdo klient dhe sipas çrregullimeve dhe sëmundjeve përkatëse mendore;
- lista ekzistuese e çmimeve (specifikimi i kosto-s sipas llojit të trajtimit, në Euro).

Standardi 17: Shtëpia për integrim në bashkësi (SHIB)

- Në Shtëpitë për integrim në: Prishtinë (Bresje), Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë dhe Gjakovë është e punësuar struktura e njejtë, kualitative dhe kuantitative, profesionale, si vijon¹⁴:
 - 8 Infermier. Në shtëpinë e dytë për integrim të çdonjërës nga strukturat e lartpërmendura administrative do të punësohen edhe shtatë infermierë.
- Shtëpitë për integrim në Bresje dhe Drenas janë pjesë e SHPSHM të Prishtinës dhe së bashku punësojnë pesëmbëdhjetë infermierë¹⁵.
- Akomodimi i mbrojtur mundësohet dhe/ose mbështetet në mënyrë të tillë që promovon mundësinë e zgjedhjes, sigurinë dhe cilësinë maksimale të mundshme të jetës për shfrytëzuesin e shërbimeve.
- Programi i akomodimit është plotësisht i integruar me trajtimet tjera dhe programet mbështetëse.
- Akomodimi është i pastër, i sigurtë dhe reflekton sa më shumë që është e mundur – preferencat e shfrytëzuesve që jetojnë atje.
- Shfrytëzuesve të shërbimeve, që jetojnë në shtëpinë për integrim iu ofrohet një varg shërbimesh të trajtimit dhe shërbimet mbështetëse, në pajtim me nevojat e tyre individuale.
- Shfrytëzuesve që jetojnë në shtëpinë për integrim u ofrohet mundësia maksimale e pjesëmarrjes në vendim-marrjet lidhur me shkallën e mbikqyrjes në objekt, dekorim, vizitorë, banorë potencialë dhe rregullat shtëpiake.

¹⁴ Në këtë numër përfshihet edhe Udhëheqësi i dy shtëpive integruese.

¹⁵ Aktualisht janë aktive Shtëpitë për integrim në: Gjakovë, Bresje, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, ndërsa nuk janë aktive në Drenas dhe Pejë; për këto struktura duhet të jenë gjashtëdhjetënjë infermier. Çdo shtëpi e parë integruese ka tetë infermierë, ndërsa e dyta shtatë. Struktura administrative e Prishtinës ka dy shtëpi për integrim, në Bresje dhe Drenas për të cilat janë kalkuluar pesëmbëdhjetë infermier.

- Akomodimi maksimalizon mundësitë e shfrytëzuesit për pjesëmarrje në aktivitetet e bashkësisë lokale.
- Stafi është adekuat për të ofruar kujdes në pajtim me nevojat e shfrytëzuesve të akomoduar ndërsa përcjellja nga stafi është 24 orëshe.
- Modalitetet e insertimit dhe sistemi i referimit menaxhohen nga Shërbimi i Shëndetit Mendor në pajtim me kriteret e vendosura.
- Shërbimi i shëndetit mendor promovon dhe mbështetë pjesëmarrjen e përkujdesësve dhe të afërmeve të shfrytëzuesve në menaxhimin e akomodimit.
- Secili shfrytëzues ka të drejtën e planit të trajtimit të tij ose saj në baza individuale sipas moshës, gjinisë dhe çrregullimit specifik mendor. Qëndrimi në shtëpi për integrim ka kohëzgjatje të përcaktuar me planin e trajtimit.

Standardi 18: Shërbimi i shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshent

- Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë (SHSHMFA) janë pjesë përbërëse e SHPSHMK dhe bashkëpunojnë ngusht me shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet relevante specialistike, shërbimet e mirëqenies sociale si dhe resurset e tjera në komunitet.
- SHSHMFA do të jenë me qasje të lehtë, integrative, të mbështetura në komunitet dhe të orientuara në promovimin, parandalimin dhe trajtimin efektiv. Theks i veçantë do të vëhet në problemet e sjelljes, vetëvrasjes në adoleshencë, traumës dhe problemeve zhvillimore. SHSHMFA do të jete i orientuar në punën më fëmijët në rrezik të lartë dhe në përforsimin e rëndësisë së faktorëve pozitiv.
- Fëmijët dhe adoleshentët më probleme të shëndetit mendor, në të gjithë vendin, duhet të trajtohen dhe të marrin shërbime që kanë kualitet të lartë dhe të njëjtë.
- **Objektivat e SHSHMFA janë:**
 - Ulja e prevalencës së problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, sidomos për fëmijët në rrezik;
 - Identifikimi i faktorëve të rrezikut si dhuna dhe zvogëlimi i pasojave të tyre në shëndetin e fëmijëve dhe adoleshenteve;
 - Sigurimi i shërbimeve të qëndrueshme, në mënyrë që të gjithë fëmijët dhe adoleshentët të kenë qasje në to;
 - Sigurimi i të drejtës së fëmijëve dhe adoleshentëve për shfrytëzimin e shërbimeve të shëndetit mendor, që përfshijnë shërbime specifike për moshë të caktuara, mbrojtje nga abuzimi apo neglizhimi, shërbime të ndara nga të rriturit dhe mbrojtje ligjore;
 - Përmirësimi i qasjes në programet parandaluese për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët;
 - Shtimi i vetëdijes për rëndësinë e shëndetit mendor, si në popullatën e gjërë ashtu edhe te profesionistët, të cilët punojnë me këto grup moshë;
 - Ndërtimi i resurseve profesionale në lëminë e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshent;
 - Shtimi i investimeve në lëminë e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve.

- Në SHSHMFA në Prishtinë do të punojnë: dy psikiatër, dy psikolog, një punëtor social, pesë infermier, dhe një punëtor ndihmës.
- Në SHSHMFA në: Mitrovicë, Gjilan, Pejë, Ferizaj, Gjakovë dhe Prizren do të punojnë: një psikiatër, një psikolog, dhe dy infermier.

Standardi 19: Qendra Integruese e Shëndetit Mendor në Shtime (QISHM)

- Qendra Integruese e Shëndetit Mendor në Shtime (QISHM) ka si synim avancimin e reformimit të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë përmes procesit të deinstitutionalizimit të klientëve psikiatrik që janë banorë në QISHM dhe shtëpitë për integrim në bashkësi, duke ofruar programe rehabilituese dhe okupuese, riintegrimin e tyre në familje dhe shoqëri, respektimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor, si dhe zhvendosjen e burimeve financiare dhe njerëzore nga QISHM në bashkësi krahas ndërrimit të destinacionit të QISHM.
- Me qëllim të realizimit të synimeve të lartëpërmendura do të vazhdojë parandalimi i pranimeve të reja në Shtime, zbatimi i programeve rehabilituese, vokacionale dhe resocializuese, si dhe ndërtimi i strukturave në bashkësi.
- Në QISHM do të jenë të punësuar: një psikiatër në orar të plotë të punës, një psikolog, tridhjetëetë infermierë, tetë punëtorë ndihmës, dhe një vozitës.

Standardi 20: Resurset njerëzore për vitin 2008 sipas standardeve të SHPSHMK (pa resurset njerëzore të punësuar në repartet psikiatrike të spitaleve dhe QKUK, si dhe pa stafin e Institutit të Psikiatriisë Forenzike).

• Psikiatër	25
- QSHMB (7 + 2)	14 + 2 = 16
- SHSHMFA	2 + 6 = 8
- QISHM	1
• Psikolog	25
- QSHMB (7 + 2)	14 + 2 = 16
- SHSHMFA	2 + 6 = 8
- QISHM	1
• Infermier	206
- QSHMB (7 + 2)	84 + 8 = 92
- SHI (7 + 1)	64
- SHSHMFA	5 + 12 = 17
- QISHM	33
• Këshilltar psikosocial	14
• Administrator ekonomik – juridik në strukturat administrative të SHPSHM	7
• Udhëheqës i shërbimit financiar buxhet dhe administratë në Mesh.	1
• Vozitës	8
• Rojtar	25
• Pastrues	14
TOTAL	325

Standardi 21: Shërbimi profesional dhe i punësimit

- Koeficientët e pagave, sipas kategorive profesionale të të punësuarve në SHPSHMK janë të njëjta në të gjitha strukturat administrative, në pajtim me sistemin unik të pagesave në sektorin publik të shëndetësisë, sipas kritereve, si vijon:

- Drejtori i strukturës administrative të SHPSHM	12
- Udhëheqësi i Qendrës së Shëndetit Mendor	9.6
- Udhëheqësi i shërbimit të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshent	9.6
- Udhëheqësi i repartit psikiatrik	9.6
- Udhëheqësi i Shtëpive për Integrim	7.2
- Udhëheqësi i shërbimit financiar – administrativ në MSH-së	9.0
- Administratori ekonomik – juridik në strukturën administrative të SHPSHM	8.4
- Kryeinfermieri i QSHM	7.8
- Kryeinfermieri i repartit psikiatrik	7.2
- Kryeinfermieri i shërbimit të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshent	7.2
- Infermierët	5.5
- Këshilltari psikosocial me fakultet	7.0
- Këshilltari psikosocial me nivel të mesëm të arsimimit	6.0
- Psikiatri	8.4
- Psikologu me shkallë të specialistit ose mbikqyrësit të specializimit	8.4
- Psikologu me licencën themelore të punës	7.2
- Punëtori social me fakultet ose nivel të lartë të arsimimit universitar	7.2
- Vozitësi	4.8
- Roja	4.2
- Pastruesi	4.0
- Shërbimet e shëndetit mendor (QSHMB) zhvillojnë aktivitete që synojnë të ofrojnë qasje të lehtësuara dhe përkrahje për shfrytëzuesit në trajnim, edukim, punësim dhe punë, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve, si vijon:
 - Të mundësojë vlerësim lidhur me nivelin e pa-aftësisë;
 - Të mundësojë aktivitete dhe trajnime edukative për klientët analfabetë;
 - Të mundësojë programe të aftësimit shkollor;
 - Të mbështesë dhe të mundësojë trajnim profesional;
 - Të mundësojë bashkëpunim me agjencionet e punësimit;
 - Të implementojë aktivitete për mbikqyrjen e klientëve gjatë punës përmes kontakteve me institucione edukative, agjencionet e punësimit, zyret e punësimit, ojq-të dhe kooperativat shoqërore;
 - Të sigurojë mundësinë e granteve të punës;
 - Përkrahja dhe mbikqyrja e aktiviteteve gjenerative nëpërmjet inkuadrimin në punë të personave me sëmundje mendore.

Standardi 22: Sistemet e dokumentimit dhe informimit klinik

- Shërbimet e shëndetit mendor përdorin "ditarin e stafit".
- Me "ditar të stafit" nëkuptohe ditari ku të gjithë punëtorët e stafit mund të shënojnë dhe të kenë qasje në informata lidhur me çfarëdo ngjarje të rëndësishme përkitazi me klientët.
- Çdo klient ka dosjen e vet klinike, të plotë dhe të azhuruar.
- Dosjet klinike duhet të përmbajnë vlerësimin e hollësishëm për: gjendjen psikike, funksionimin social, gjendjen familjare dhe sociale, si dhe historikun klinik dhe personal; përfshirë planin e trajtimit, përshkrimin e intervenimeve të planifikuara për zbatim; përshkrimin e intervenimeve të kryera si dhe eventualisht rezultatet e arritura.
- Dosjet klinike janë lehtë të arritshme.
- Shërbimet e shëndetit mendor posedojnë sistemin unik të informimit, pjesë e sistemit të informimit shëndetësorë, që përfshin:
 - Dokumentet e shkruara me dorë;
 - Sistemin e kompjuterizuar të mbajtjes dhe ruajtjes së shënimeve;
 - Grumbullimin sistematik të të dhënave;
 - Regjistri i saktë i të dhënave (emri, mbiemri, data e lindjes, gjinia, adresa, qyteti);
 - Të dhënat demografike (gjendja martesore, situata prindërore dhe familjare, statusi profesional, aktiviteti i punës, niveli i edukimit, strehimi, të ardhurat);
 - Marrëdhënia me shërbimin (shfrytëzues i ri, i vjetër, i rikthyer);
 - Diagnoza (sipas ICD 10);
 - Lista e intervenimeve;
 - Aktivitetet e pranimit;
 - Aktivitetet terapeutike dhe mbështetëse të drejtuara ndaj klientit;
 - Aktivitetet rehabilituese;
 - Aktiviteti i drejtuar kah familja dhe rrjeti mbështetës social;
 - Aktiviteti i përkrahjes sociale;
 - Aktiviteti i koordinimit dhe auditimit;
 - Përcjellja e të dhënave dhe evaluimi i të dhënave.

Standardi 23: Evaluimi i shërbimeve të shëndetit mendor dhe hulumtimit.

- SHPSHMK ka strategji të evaluimit e cila promovon pjesëmarrjen e stafit, shfrytëzuesve të shërbimeve, përkujdesësve të tyre, si dhe ofruesve të shërbimeve të ndryshme në bashkësi.
- Rekomandohet që shërbimet e shëndetit mendor të zbatojnë ose të marrin pjesë në aktivitete të duhura hulumtuese. Propozimet për projektet hulumtuese shqyrtohen nga komiteti etik, që formohet në bashkëpunim me asociacionet profesionale të psikiatërve dhe psikologëve.

SHTOJCA 2

Lista unike e shërbimeve në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor të Kosovës

Qendrat e shëndetit mendor në bashkësi:

1. Aktivitetet edukative dhe arsimore të nivelit klinik;
2. Vizita individuale specialistike psikiatrike (e parë; e përsëritur);
3. Vizita individuale e psikologut (e parë; e përsëritur);
4. Vizita shtëpiake e ekipit mobil multidisiplinar;
5. Konsulta individuale nga këshilltari psikosocial (e parë; e përsëritur);
6. Konsulta individuale nga infermierët (e parë; e përsëritur);
7. Konsulta individuale nga punëtori social (e parë; e përsëritur);
8. Dhënja e mendimit të përbashkët konziliar;
9. Mendime dhe raporte të tjera specialistike;
10. Kujdesi ditor;
11. Dhënja e terapisë parenterale në raste emergjente;
12. Psikoedukimi në grupe shumë familjare (10 familje të përfaësuar me dy anëtarë);
13. Psikoterapi e shkurtër suportive;
14. Psikoterapi e shkurtër psikodinamike;
15. Teknikat mendje trup;
16. Teknikat e relaksimit neuromuskulor;
17. Takimet e bashkësisë terapeutike;
18. Shërbimet konsultative në sistemin penal korrektues;
19. Shërbime konsultative për shërbimet e mjekësisë familjare;
20. Shërbimet konsultative për shërbimet e mirëqenies sociale;
21. Shërbimet konsultative telefonike si pjesë e intervenimit në gjendje të krizës;
22. Shërbimet e tjera në komunitet;
23. Aktivitete rehabilituese dhe resocializuese;
24. Aktivitete të edukimit shëndetësor.

Klinika e Psikiatrisë në QKUK dhe repartet psikiatrike në Spitale

1. Aktivitetet edukative arsimore të nivelit universitar dhe klinik ¹⁶;
2. Aktivitetet edukative dhe arsimore të nivelit klinik ¹⁷
3. Vizita emergjente psikiatrike për të rritur dhe fëmijë¹⁸;

¹⁶ Shërbimet edukative dhe arsimore që ofrohen në Klinikën e Psikiatrisë të QKUK;

¹⁷ Shërbimet edukative dhe arsimore që ofrohen në Departamentet e Psikiatrisë në Spitale.

¹⁸ Të gjitha shërbimet e përcaktuara për të rritur vlejné si shërbime të veçanta për fëmijë dhe adoleshent.

4. Vizita individuale specialistike psikiatrike;
5. Vizita e individuale specialistike e psikologut (varësisht nga testet që shfrytëzohen për vlerësim);
6. Vlerësimi konziliar i psikologut dhe psikiatrit për aftësitë psikike të klientit;
7. Vizita konsultative psikiatrike në repartet e tjera të QKUK;
8. Vizita konsultative në sistemin penal korrektues;
9. Shërimi hospitalor me mjekim intensiv (dita e shërimit spitalor);
10. Shërimi hospitalor me mjekim gjysmë intensiv (dita e shërimit spitalor);
11. Shërimi hospitalor me mjekim forenzik (dita e shërimit spitalor);
12. Shërimi hospitalor me ekzaminim forenzik (dita e shërimit spitalor);
13. Shërimi hospitalor në repart të hapur (dita e shërimit spitalor);
14. Ekspertiza ambulatorie forenzike;
15. Mendimet individuale specialistike për komisione invalidore;
16. Mendimet konziliare specialistike për komisione invalidore;
17. Trajtimi i sëmundjeve të vartësisë (dita e shërimit spitalor);
18. Konsulta me prindër, kujdestar apo përfaqësues ligjor;
19. Psikoterapia individuale supportive;
20. Psikoterapia individuale e shkurtër psikodinamike;
21. Psikoterapi grupore;
22. Psikoterapi familjare;
23. Mbledhjet e bashkësisë terapeutike.

Shtëpia për integrim në bashkësi

1. Dita e qëndrimit, përfshirë: ushqimin, barnat dhe kostot e tjera të qëndrimit 24 orësh në shtëpinë për integrim;
2. Programe rehabilituese, rekreative, okupuese dhe sportive, individuale dhe grupore, në shtëpinë për integrim;
3. Mësim të aftësive të humbura për jetën e përditshme;
4. Aktivitete ditore, rekreative, okupuese, rehabilituese dhe sportive, individuale dhe grupore, jashtë shtëpisë për integrim;
5. Ndërtim të marrëdhënieve terapeutike me familjet dhe rrethin;
6. Përkrahje sociale dhe aktivitete këshilluese juridike.

Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë:

1. Aktivitetet edukative dhe arsimore të nivelit klinik;
2. Vizita individuale specialistike psikiatrike (e parë; e përsëritur);
3. Vizita individuale e psikologut (e parë; e përsëritur);
4. Konsulta individuale nga infermieri (e parë; e përsëritur);
5. Konsulta individuale nga punëtori social (e parë; e përsëritur);
6. Dhënja e mendimit të përbashkët konziliar;
7. Mendime dhe raporte të tjera specialistike;

8. Kujdesi ditor;
9. Dhënja e terapisë parenterale në raste emergjente;
10. Psikoedukimi në grupe shumë familjare (10 familje të përfaësuar me dy anëtarë);
11. Psikoterapi e shkurtër suportive;
12. Psikoterapi në kuadër të lojës;
13. Teknikat mendje trup;
14. Shërbimet konsultative në sistemin penal korrektues;
15. Shërbime konsultative për shërbimet e mjekësisë familjare;
16. Shërbimet konsultative për shërbimet e mirëqenies sociale;
17. Shërbimet konsultative telefonike si pjesë e intervenimit në gjendje të krizës;
18. Shërbimet e tjera në komunitet;
19. Aktivitete rehabilituese dhe resocializuese;
20. Aktivitete të edukimit shëndetësor.

Qendra për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime

1. Dita e qëndrimit, përfshirë: ushqimin, barnat dhe kostot e tjera të qëndrimit 24 orësh në qendër;
2. Programe rehabilituese, rekreative, okupuese dhe sportive, individuale dhe grupore, në qendër;
3. Mësim të aftësive të humbura për jetën e përditshme;
4. Aktivitete vokacionale (trajnim për veprimtari të ndryshme punuese);
5. Aktivitete prodhuese (gjenerative);
6. Aktivitete ditore, rekreative, okupuese, rehabilituese dhe sportive, individuale dhe grupore, jashtë qendrës;
7. Psikoedukim në grupe shumëfamiljare;
8. Ndërtim të marrëdhënieve terapeutike me familjet dhe rrethin;
9. Përkrahje sociale dhe aktivitete këshilluese juridike.

SHTOJCA 3

Burimet ekzistuese, njerëzore dhe institucionale, në SHPSHMK

Burimet njerëzore në QSHMB dhe SHI (Mars 2007)

	QSHMB						SHIB	
	Psikiatër	Psikolog	Këshilltar PS	Punëtor social	Infermier	Staf ndihmës	Infermier	Staf tjetër
Prishtina	1	1	1	2	11	6	7	x
Gjakova	1	x	2	1	10	4	8	x
Mitrovica	2	x	x	1	8	5	5	x
Peja	1	1	2	1	9	4	x	x
Gjilani	2	x	x	1	12	7	7	2
Prizreni	1	1	1	1	10	7	6	x
Ferizaj	2	x	2	1	12	5	3	x
Gjithsejtë	10	3	8	8	72	38	36	2

Burimet njerëzore në Klinikën e psikiatrisë dhe njësin e kujdesit intensiv psikiatrik të QKUK si dhe repartet psikiatrike në spitale (Mars 2007)

	Psikiatër	Psikolog	Punëtor social	Infermier	Specializant të Psikiatrisë	Staf tjetër
QKUK	10	3	1	40	7	x
Gjakovë	2	x	x	15	2	x
Mitrovicë	x	x	x	x	x	x
Pejë	2	x	x	6	1	x
Gjilan	2	x	x	11	2	4
Prizren	3	x	x	14	2	3
Ferizaj					1	x
Gjithsejtë	19	3	1	86	15	7

Burimet njerëzore në sektorin privat të shëndetësisë (Mars 2007)

	Psikiatër	Psikolog
Prishtinë	6	2
Gjakovë	2	1
Mitrovicë	x	x
Pejë	1	x
Gjilan	1	1
Prizren	1	1
Ferizaj	x	x
Gjithsejtë	11	4

Burimet njerëzore dhe institucionale në QISHM (Mars 2007)

	Psikiatër	Psikolog	Punëtor social	Infermier	Ndihmës infermier	Staf tjetër	Shtretër	Klient
QISHM Shtime 2983/m2	1/gjysëm orari	x	x	16	17	8 (5 sigurim, 3 punëtorë teknik)	80 (reparti 2, 3, 4)	72 (29 joshqiptar, M-39, F-33)

Burimet njerëzore të shëndetit mendor në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor dhe mjediset e tjera

	Psikiatër	Psikolog
Prishtinë	7	1
Gjakovë	x	1
Mitrovicë	x	x
Pejë	1	x
Gjilan	x	1
Prizren	1	x
Ferizaj	x	x
Gjithsejtë	9	3

Burimet institucionale në SHPSHK (Mars 2007)

	QSHMBm ²	SHI/m ²	QKUK/m ²	S/m ²	NJI??	F&A/m ² ??	QISHM ²	Tjera
Prishtinë	2/?	2/?	1/?	x	1	?	x	x
Gjakovë	1/369	1/382	x	1/800	1	1	x	x
Mitrovicë	1/310	1/360	x	x	x	1	x	x
Pejë	1/820	1/340	x	1/200	x	1	x	x
Gjilan	1/311	1/500	x	1/?	x	1/18	x	x
Prizren	1/310	1/360	x	1/990	x	1	x	x
Ferizaj	1/850	1/520	x	x	x	1	1/2983	x
Gjithsejt	8/?	8/?	1/?	4?	2/2	x	1	x

SHTOJCA 4

PROJEKSIONI BUXHETOR

BUXHETIMI I PLANIT TE STRATEGJISE SE SHENDETIT MENDOR TE KOSOVES 2008-2013

Kodi	Kategorit ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
0100	Burimet e Financimit	4,058,475	4,447,194	4,921,278	5,337,738	5,503,106	4,495,256
0200	Te hyrat vetanake	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
	Numri i Stafit	466	552	608	665	707	707
011100	Pagat dhe mëditjet	1,285,299	1,374,058	1,506,694	1,647,698	1,748,671	1,748,671
011110	Pagat Bruto	1,128,834	1,308,627	1,434,947	1,569,236	1,665,401	1,665,401
011140	Kontributi i punëdhënësit	56,442	65,431	71,747	78,462	83,270	83,270
011200	Pagat për punë jashtë orarit, shtesat dhe pagesat tjera.	100,023					
13000	Mallrat e Shërbimit	1,284,040	1,809,796	2,113,894	2,352,541	2,587,795	2,388,295
013100	Shpenzimet e udhëtimit	21,583	38,400	48,000	57,100	64,800	64,800
013130	Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	21,583	38,400	48,000	57,100	64,800	64,800
013140	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit						
013300	Shërbimet e telekomunikimit	20,810	32,900	41,900	49,723	57,670	57,670
013310	Internet	12,279	19,650	25,050	29,646	34,550	34,550
013320	Shpenzimet tjera telefonike-Vala 900	8,257	12,950	16,550	19,777	22,820	22,820
013330	Shpenzimet postare	274	300	300	300	300	300
013400	Shpenzimet për shërbimet	40,820	92,520	126,320	145,099	216,820	229,220
013410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit & bashkpun. OJQ	15,777	54,400	78,600	87,781	104,700	114,700
013420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	554	460	460	460	460	460
013430	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	2,290	2,300	2,300	2,300	2,300	2,300
013440	Shërb. ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	22,199	35,360	44,960	54,558	109,360	111,760
013500	Blerja e mobiljeve dhe pajisjeve < 1000 Euro	14,341	20,260	20,260	23,850	21,060	21,060
013501	Mobilje	5,062	7,660	7,660	8,458	8,460	8,460
013502	Telefona	321	350	350	321	350	350
013503	Kompjuterë	1,321	500	500	3,321	500	500
013504	Hardver për teknologji Informative						
013505	Makina Fotokopjuese	500					
013506	Pajisje speciale Mjekesore	1,137	5,750	5,750	4,600	4,600	4,600
013507	Pajisje të shërbimit policor						
013508	Pajisje Trafiku						
013509	Pajisje Tjera	6,000	6,000	6,000	7,150	7,150	7,150
013511							
013512							
013513							
013514							
013521							
013522							
013523							
013524							
013525							
013526							
013527							
013550	Blerja e mobiljeve dhe pajisjeve 1000 - 5000 Euro	124,952	209,350	259,350	256,350	250,150	43,650
013551	Mobilje	37,575	56,600	56,600	56,600	53,600	14,600
013552	Telefona	579	1,400	1,400	1,400	1,200	200
013553	Kompjutere	7,603	12,650	12,650	9,650	8,150	1,650
013554	Hardver për teknologji informative	15,000					
013555	Makina fotokopjuese	1,958	3,000	3,000	3,000	2,500	500
013556	Pajisje Speciale Mjekesore	6,870	107,000	157,000	157,000	157,000	7,000
013557	Pajisje të Shërbimit Policor						
013558	Pajisje Trafiku						
013559	Pajisje Tjera	55,367	28,700	28,700	28,700	27,700	19,700
013600	Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve	612,450	838,540	938,740	1,038,807	1,169,920	1,169,920
013610	Furnizimet për zyrë	29,746	37,600	47,100	56,552	64,200	64,200
013620	Furnizime për ushqim dhe pije (jo për dreka zyrtar)	323,837	378,940	457,140	534,780	594,420	594,420
013622	Furnizimi me Banderola - Tiketa Fiskale						
013630	Furnizime mjekësore	202,865	348,800	348,800	348,800	402,600	402,600
013640	Furnizime pastrimi	37,825	48,400	55,900	63,395	69,400	69,400
013650	Furnizim me veshëmbathje	15,887	22,500	27,500	32,980	37,000	37,000
013660	Akomodimi	2,290	2,300	2,300	2,300	2,300	2,300
013670	Municion dhe armë zjari						
013680	Tiketa Siguruese						
013700	Derivatet dhe lëndët djegëse	212,421	282,361	335,160	386,864	426,510	426,510
013710	Vaji	1,232	2,111	2,510	3,558	3,860	3,860

013720	Naftë për ngrohje qëndrore	13,550	26,750	26,750	18,716	18,750	18,750
013730	Vaj për ngrohje	131,000	163,000	195,000	235,000	259,000	259,000
013740	Mazut	15,685	15,800	15,800	15,800	15,800	15,800
013750	Thëngjill						
013760	Dru						
013770	Lëndë Djegëse për gjenerator	8,593	12,120	14,520	17,966	19,770	19,770
013780	Karburante për vetura	42,361	62,580	80,580	95,824	109,330	109,330
013800	Llogaritë e avansit	42,251	62,000	78,000	98,230	112,000	112,000
013810	Avansi për para të gatëshme	41,335	61,000	77,000	97,230	111,000	111,000
013820	Avanset për udhëtime zyrtare	916	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
013900	Shërbimet financiare-provizioni bankar	0	0	0	0	0	0
013911	Provizioni bankar-AQBK						
013912	Provizioni bankar-RBKO						
013913	Provizioni bankar-Pro Credit Bank						
013914	Provizioni bankar-Banka e re e Kosovës						
013915	Provizioni bankar-Banka Private e Biznesit						
013916	Provizioni bankar-Banka Ekonomike						
013917	Provizioni bankar-KasaBanka						
013950		22,870	34,755	45,955	57,155	65,555	65,555
013951	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	22,870	34,755	45,955	57,155	65,555	65,555
013952	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera						
014000	Mirëmbajtja	156,660	176,840	190,739	205,408	165,890	165,890
014010	Mirëmbajtja dhe riparimet e automjeteve	26,449	39,150	51,150	64,166	73,250	73,250
014020	Mirëmbajtja e ndërtesave	22,270	22,050	22,050	22,240	22,050	22,050
014030	Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore	2,784	2,800	2,800	2,800	2,800	2,800
014040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	35,062	36,440	36,539	36,291	36,440	36,440
014050	Mirëmbajtja e orendive dhe pajimeve tjera	70,095	76,400	78,200	79,911	31,350	31,350
014100	Qiraja	0	0	0	0	0	0
014110	Qiraja për ndërtesa						
014120	Qiraja për tokë						
014130	Pajisjet						
014140	Qiraja për makineri						
014150	Shpenzimet për shfrytëzimet e hapësirave tjera						
014200	Shpenzimet e marketingut	9,424	14,410	19,010	23,495	26,960	21,560
014210	Reklammat dhe konkurset	3,566	6,100	7,700	9,287	10,500	5,100
014220	Botimet e publikimeve	5,858	8,310	11,310	14,208	16,460	16,460
014300	Shpenzimet e reprezentacionit	5,458	7,460	10,460	10,460	10,460	10,460
014310	Drekat zyrtare	5,458	7,460	10,460	10,460	10,460	10,460
013200	Shpenzimet e komunalive	189,136	248,340	285,690	322,499	357,640	358,290
013210	Rryma	82,412	110,000	128,550	142,945	159,500	160,150
013220	Uji	33,974	50,140	58,140	71,219	79,640	79,640
013230	Mbeturinat	22,445	30,470	36,470	42,250	46,970	46,970
013240	Ngrohja qëndrore	38,737	39,630	39,630	38,895	39,630	39,630
013250	Telefoni-PTK me fatura	11,568	18,100	22,900	27,190	31,900	31,900
020000	Subvencionet e Transferet	0	0	0	0	0	0
021000	Subvencionet	0	0	0	0	0	0
021110	Subvencionet për entitetet publike						
021120	Subvencionet për entitete publike kulturore						
021200	Subvencionet për Entitetet Jo-publike						
022000	Transferet	0	0	0	0	0	0
022100	Transferet për qeveri tjera						
022200	Pagesat për përfituesit individualë						
022210	Pensionet bazë						
022220	Pensionet për të paafët						
022230	Pensionet e ndihmës sociale						
022240	PNS-Kategoria I-(për anëtarët e familjeve)						
022250	PNS-Kategoria II-(për anëtarët e familjeve)						
022260	Pagesat për invalidët e luftës						
022270	Pagesat për invalidët civilë						
022280	Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
022290	Pensionet e përkohshme të Trepçës						
022295	Kompensimi për të denuarët pa bazë						
022296	Giobat e vendimeve gjyqësore						
030000	Shpenzimet Kapitale	1,300,000	1,015,000	1,015,000	1,015,000	809,000	0
031000	Përvetësimi i pasurive kapitale fikse	1,300,000	1,015,000	1,015,000	1,015,000	809,000	0
031110	Ndërtesat rezidenciale	1,300,000	920,000	920,000	920,000	736,000	
031120	Ndërtesat jorezidenciale						
031130	Struktura tjera						
031200	Ndërtimi i rrugëve						
031300	Kanalizimi						

031400	Ujësjellësi						
031510	Furnizimi me rrymë, gjenerimi dhe transmisioni						
031600	Pajisje të tekn. informative (Vlera mbi > 5000Eur)						
031700	Automjete transporti		60,000	60,000	60,000	45,000	
031800	Makineria						
031900	Kapital tjetër Gjenerator		35,000	35,000	35,000	28,000	
032000	Blerja e tokës dhe pasurive të paprekshme	0	0	0	0	0	0
032100	Toka						
032200	Pasuritë e paprekshme						
033000	Transferet kapitale (përvetësimet kapitale)	0	0	0	0	0	0
033100	Transferet kapitale - entitetet publike						
033200	Transferet kapitale - entitetet jopublike						
039000	Mjetet e rezervuara	0	0	0	0	0	0
039999	Rezervat						

2007	1,315,051	
2008	4,058,475	466
2009	4,447,194	552
2010	4,921,278	608
2011	5,337,738	665
2012	5,503,106	707
2013	4,495,256	707


Kostoja e Strategjise se SHMK 2008-2013

28,763,047

SHTOJCA 5

Aneksi – Disa statistika mbi hospitalizimet në Qendrën Klinike Universitare të Psikiatrisë në Prishtinë dhe repartet tjera psikiatrike në regjione.


1. Niveli i hospitalizimeve në Qendrën Klinike Universitare të Psikiatrisë në Prishtinë (mungojnë një pjesë e shënimeve për 2003). Shihet një trend i rënies.



2. Niveli i hospitalizimeve në Qendrën Klinike Universitare të Psikiatrisë në Prishtinë (mungojnë një pjesë e shënimeve për 2003). Shihet një trend i rënies.

Viti	Numri i hospitalizimeve	Përqindja e rrënies
1999	820	- 32 %
2000	1211	Viti bazë
2001	1134	- 6%
2002	1109	- 8%
2003	476*	
2004	925	- 24%
2005	860	- 29%

3. Mesatarja e ditëve të qëndrimit në QKU të Psikiatrisë në Prishtinë. (2003 mungojnë disa shënime)



4. Numri i hospitalizimeve nga regjioni i Mitrovicës pas hapjes së QSHM (10.10.2002) në QKU të Psikiatrisë në Prishtinë

	Mitrovicë	Vushtrri	Skënderaj	Albana	Totali
1999	43	31	21		95
2000	72	62	40		174
2001	75	65	23	1	162
2002	90	68	52	3	213
2004	71	66	40	1	178
2005	76	59	37		172

5. Numri i hospitalizimeve nga regjioni i Ferizajit pas hapjes së QSHM (2001) në QKU të Psikiatrisë në Prishtinë

	Ferizaj	Shtërpce	Kaçanik	Shtime	Totali
1999	43	4	23	5	75
2000	88		29	21	138
2001	66		21	12	99
2002	73		23	12	108
2004	60	3	16	19	98
2005	51		17	6	74

Grupi i punës

Ferid Agani (Kryesues)

Ismet Abdullahu

Jusuf Telaku

Jusuf Ulaj

Neki Juniku

Mahmud Lila

Gani Shabani

Bahri Goga

Qemajl Rexhepi

Pashk Buzhala

Skender Kandiq

Mimoza Shahini

Besnik Stuja

Aliriza Arënliu

Genc Ymerhalili

Arbresha Turjaka

Afërdita Ademi

Niman Bardhi

Feride Rushiti

Sarije Doko

Shukrije Statovci

Kujtim Xhelili

Lumnije Qerimi

Muharrem Asllani

Naim Fanaj

Afërdita Uka

Henerjeta Vula

Vjollca Berisha

Fahri Drevinja

Milazim Gjoci

Nazmije Ibishi

Ajet Bunjaku

Blerta Perolli

Kaltërina Kelmendi

Shaban Mecinaj

Blerina Hoxha

Afrim Cana

Eroll Shporta

Safet Blakaj

